

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6677
E premte, 12 gusht 2022
çmimi 0.40

Luftë në Kosovë, e kush do ta bëjë këtë luftë?!

Shkruan: Behxhet
SHALA-BAJGORA

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DREJTUESIT E SHTETIT TË KOSOVËS DHE ATA TË SERBISË E AKUZOJNË NJËRI-TJETRIN
PARA TAKIMIT TË BRUKSELIT | FAQE 4-5

KURTI DHE VUÇIQI REPLIKOJNË PËRA TAKIMIT TË 18 GUSHTIT



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen në Bruksel më 18 gusht. Ky takim vjen pas tensioneve të fundit në veri të Kosovës. Para këtij takimi, Kurti dhe Vuçiqi kanë vazhduar të replikojnë nga distanca, duke shkëmbyer edhe akuza kundër njëri-tjetrit. Kurti e ka akuzuar Beogradin zyrtar se është duke tentuar ta

përkallëzohet situatën në veri në konflikt të armatosur. Ai ka thënë se barrikatat në veri janë vendosur për shkak të lajmeve të rreme, veçanërisht në lidhje me vendimet e Kosovës për reciprocitet për targa dhe dokumentet serbe, ndërsa presidenti Vuçiq ka thënë se autoritetet e Kosovës dëshirojnë ta sulmojnë veriu dhe serbët atje

OPINION

KURTHET E ASOCIACIONIT PËR FUNKSIONALITETIN E SHTETIT TË KOSOVËS F. 3

Shkruan:
Valon MURATI



AKTUALE



GJERMANIA DHE KOSOVA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJEN MBI VARRET GJERMANE TË LUFTËS NË KOSOVË F. 7

SHËRBIMI I RADIOTERAPISË NË KLINIKËN E ONKOLOGJISË ËSHTË FUNKSIONAL F. 3

PARLAMENTI LETONES E CILËSON RUSINË SHTET SPONSORIZUES I TERRORIZMIT F. 2

EKONOMI



RAMA: PA LLOGARITUR VËLLEZËRIT DHE MOTRAT NGA KOSOVA KEMI RRITJE TË TURIZMIT F. 8

ATK-ja: PËR 7 MUAJ JANË REALIZUAR MBI 435 MILIONË EURO NGA TATIMET F. 8

ZEMAJ AKUZON QEVERINË SE PO I LË QYTETARËT PA SHËRBIME SHËNDETËSORE

FAQE 3



IZRAELI DHURON 70 KARROCA PËR PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA

FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sekretari amerikan i Mbrojtjes premtan trajnime ushtarake për vendet baltike

RIGA, 11 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) do të kryejnë më shumë stërvitje ushtarake me vendet baltike, siç është Letonia, dhe do të ofrojnë trajnime të shtuara, tha më 10 gusht sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin. Në një konferencë për medie me ministrin e Mbrojtjes të Letonisë, Artis Pabriks në Riga, ai tha se nëse është e nevojshme, Uashingtoni mund të sjellë më shumë

trupa amerikane për ta forcuar rajonin kundër çdo kërcënimi të mundshëm nga Rusia.

Austin, i cili po qëndron në një vizitë dyditore në Letoni, tha se planet për të bërë rotacione të vazhdueshme të forcave në Baltik janë që të përdorin trupa nga brigadat e ShBA-së në Rumani dhe pjesë të tjera të Evropës, por "ne mund të sjellim edhe forca nga Shtetet e Bashkuara".

Gjatë vizitës së tij, Austin

ripërsëriti vazhdimisht angazhimin e Amerikës për të ndihmuar rajonin që të mbrohet.

Austin është sekretari i parë i Mbrojtjes i ShBA-së që viziton Letoninë në gati tri dekada, duke theksuar rëndësinë e shtuar të vendeve baltike që qëndrojnë në skajin perëndimor të Rusisë.

Pentagoni tha se shefi i fundit i Mbrojtjes i ShBA-së që shkoi në Letoni ishte William Perry në vitin 1995.



Konflikti në Ukrainë pritet t'i kushtojë Gjermanisë mbi 260 miliardë euro



Fushat që vuajnë më së shumti

Një nga humbësit e mëdhenj në situatën aktuale do të jetë sërish industria e gastronomisë dhe hotelierisë, e cila është goditur keq edhe nga pandemia. Këto fusha ekonomike do të ndiejnë dukshëm edhe humbjen e fuqisë blerëse të qytetarët. "Për shkak të shpenzimeve më të ulëta të konsumatorëve, do të ulet edhe numri i punonjësve në këto fusha", thotë studimi. Humbës të tjerë do të jenë sektorët me energji, si industria kimike dhe prodhimi i metaleve, por edhe shërbimet sociale.

Për vitin 2030, studimi sheh një efekt pozitiv prej 60 mijë vende të reja pune, por kjo vlen vetëm nëse çmimet e energjisë nuk rriten edhe më shumë. Nëse kjo ndodh, Gjermania do të rrëshqasë në recesion, paralajmëroi Weber. Në një skenar tjetër, ku çmimet e energjisë rriten dy herë më shpejt, studiuesit shohin ndikimin më të madh në tregun e punës në vitin 2024, me 660 mijë punëtorë më pak sesa sikur të mos kishte luftë. /Deutsche Welle/

BERLIN, 11 GUSHT - Lufta në Ukrainë dhe çmimet e larta të energjisë po i kushtojnë Gjermanisë qindra miliarda euro, thuhet në një studim të fundit. Ekonomia gjermane do të humbasë si pasojë e këtyre zhvillimeve deri në vitin 2030 mbi 260 miliardë euro. Ky është konstatimi i një studimi që kanë punuar së bashku tre institute kërkimore: Instituti për

Tregun e Punës dhe Formimin Profesional (IAB), Instituti Federal për Formimin Profesional dhe Shoqëria për Kërkimin e Strukturës Ekonomike. Sipas raportit, konflikti po dëmton edhe punësimin. Vitin e ardhshëm rreth 240 mijë veta më pak mund të punësohen sesa para luftës – mesatarja për vitet 2022-2028 do të ishte 150 mijë njerëz.

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i rregulluar me çmimin në vitin 2023 do të jetë rreth 1.7 për qind më i ulët sesa po të mos kishte ndodhur sulmi rus në Ukrainë. "Rritja ekonomike po dobësohet veçanërisht nga rritja e çmimeve të lëndëve të para fosile. Ato po rëndojnë si ekonominë e eksportit, po ashtu edhe konsumin e familjeve private", thuhet në

raport. Për parashikimin e tyre, studiuesit supozuan se sanksionet kundër Rusisë do të mbeten në fuqi deri në vitin 2030, edhe nëse lufta përfundon më parë. "Për shkak të efekteve të luftës, rritja e parashikuar pas pandemisë Covid-19 ka dështuar", shpjegoi Enzo Weber nga IAB.

Parlamenti letones e cilëson Rusinë shtet sponsorizues i terrorizmit

RIGA, 11 GUSHT - Ligjvënësit në Letoni e kanë cilësuar Rusinë si shtet sponsorizues i terrorizmit, duke përmendur si arsye pushtimin e paprovokuar rus të Ukrainës, aktivitetet e saj ushtarake në Siri dhe disa raste të helmimit të kritikëve të Kremlinit. Parlamenti letones të enjten e ka miratuar rezolutën për Rusinë. Në favor të kësaj rezolute kanë votuar 67 deputetë, ndërsa 16 kanë abstenuar. Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse,

Maria Zakharova, ka shkruar në rrjetin social "Telegram", se rezoluta e Letonisë ishte "ksenofobe". Përmes rezolutës, ligjvënësit dënojnë "dhunën e Rusisë kundër civilëve në përpjekjet e shtetit për të përfituar politikisht" dhe dënojnë përdorimin e municioneve të ndaluara "për të mbjellë frikë dhe për t'i vrarë civilët pa dallim".

Parlamenti i Letonisë, përmes rezolutës, u ka bërë thirrje edhe shteteve të tjera që t'i

bashkohen në këtë vendim. Po ashtu, Letonia i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian që ta ndalojë lëshimin e vizave për shtetasit e Rusisë dhe Bjellorusisë, duke theksuar se pushtimi rus i Ukrainës po kryhet "me mbështetjen dhe përfshirjen e regjimit bjellorus". Qëkur ka nisur pushtimi rus i Ukrainës më 24 shkurt, Ukraina ka thënë se Moska po përdor territorin bjellorus për të kryer sulme ajrore ndaj territorit ukrainas.



Shërbimi i radioterapisë në Klinikën e Onkologjisë është funksional

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se shërbimi i radioterapisë në Klinikën e Onkologjisë së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është plotësisht funksional. Aktualisht kësaj procedure i nënshtrohen më shumë se 90 pacientë, kurse pacientët që

janë në pritje trajtohen sipas listës së planifikuar nga mjekët onkologë. Sipas ShSKUK-së, Klinika e Onkologjisë ka një furnizim stabil me barna e citostatikë dhe përmbush 80 për qind të kërkesave, derisa është duke u punuar me angazhim të plotë që të sigurohet edhe pjesa tjetër.

Gjithashtu, menaxhmenti i ShSKUK-së, i emëruar së fundmi, është duke punuar intensivisht për t'i hartuar protokollet unike, në bazë të të cilave do të bëhet trajtimi. Përshkrimi i terapisë do të bëhet vetëm përmes konsiliumeve mjekësore, që janë kompetente për përshkrim të terapisë onkologjike.



Zemaj akuzon qeverinë se po i lë qytetarët pa shërbime shëndetësore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ish-ministri i Shëndetësisë dhe deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, e ka cilësuar qeverinë Kurti të paaftë për menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19. Sipas tij, vetëm për më pak se katër javë në Kosovë kemi 30 mijë raste me Covid 19. "Paaftësia qeverisëse dhe mashtrimi i lë qytetarët pa shërbime shëndetësore. Me pak se katër javë kemi mbi 30 000 raste me Covid-19, apo 1 154 të infektuar në ditë. Vetëm për këto ditë kemi 33 jetë të humbura të qytetarëve nga Covid-19. Ky rezultat është në vazhden e dështimeve të paaftësisë qeverisëse, e cila mendonte se

mund ta menaxhojë 'online' pandeminë si dhe 'online' sektorin e shëndetësisë. Është kjo qeveri që profesionistët shëndetësorë vazhdon t'i trajtojë me lëmoshë, gjersa vetëm për dy muaj 108 profesionistë shëndetësorë kanë lënë vendin, ndër ta edhe 36 specializantë", ka shkruar Zemaj në "Facebook". Ai e ka akuzuar qeverinë Kurti edhe për mungesë të barnave esenciale në spitalet e Kosovës. "Është kjo qeveri që javë më parë nuk ua vazhdoi kontratat mbi 1 200 pjesëtarëve të stafit mbështetës në luftën kundër pandemisë. Në vetëm këto javë të kësaj qeverie janë stërzgatur listat e pritjes së qytetarëve për t'i marrë shërbimet shëndetësore, duke mbërritur deri në mesin e vitit 2023. Në vetëm këto javë të

kësaj qeverie vazhdon mungesa e barnave në listën esenciale e cila tashmë është bërë e zakonshme dhe e tmerrshme për pacientët. Në vetëm këto javë të kësaj qeverie, si shumë medikamente të tjera, po mungon edhe medikamenti 'Pembrolizumab', e që është esencial për pacientët e sëmurë me kancer, ndërsa pritja për t'i marrë është nën mëshirën selektive të përzgjedhjes", ka shkruar Zemaj. Po ashtu, Zemaj e ka akuzuar Ministrinë e Shëndetësisë për keqmenaxhim. "Në vetëm këto javë të kësaj qeverie, pajisjet e radioterapisë u zhytën në ujë në Klinikën e Onkologjisë, fatkeqësisht pacientët nuk e morën këtë shërbim për gati dy javë, e duke i gënjyer pacientët edhe sot presin në radhë të

pritjes, gjersa paaftësia qeverisëse po vazhdon gjumin e thellë. Në vetëm këto javë të kësaj qeverie, sipas KDI-së, Ministria e Shëndetësisë paguan 280 për qind më shtrenjtë lgr 'Paracetamol' për injeksion në krahasim me vlerën e tregut me pakicë. Edhe në këto javë të kësaj qeverie vazhdon të dominojnë arroganca, mosveprimi, propaganda, jodëgjueshmëria profesionale, tipare këto të qeverisjeve të paafta dhe populliste", ka shkruar Zemaj, duke shtuar se qeveria Kurti nuk i ka marrë për bazë propozimet e opozitës për shëndetësinë. "Në vetëm këto javë të kësaj qeverie, përkundër të gjithave e gjithçkaje, ne si parti opozitare kemi ofruar Ligjin për Shëndetësinë, në mënyrë që t'u dalim në mbrojtje

qytetarëve dhe profesionistëve shëndetësorë, ndërsa si kundërpërgjigje kemi marrë padëgjueshmërinë. Këto janë vetëm disa nga dështimet e fundit të kësaj qeverie, që e bëjnë epilogun e tmerrshëm në fushën e shëndetësisë, ku burim parësor definitivisht e kanë paaftësinë. Mos të harrojmë se ditë më parë ministri i Shëndetësisë ka deklaruar se në rast dështimi ai kthehet nga ka ardhur. Pra, së pari është e frikshme se si vetëm ai dhe qeveria e tij nuk po e sheh dështimin e tyre të thellë në shëndetësi. Së dyti, në të njëjtën frymë, vetëm këta vendosin nëse kanë dështuar apo jo, dhe në rast se e pranojnë dështimin, vetëm atëherë zyrtarizohet paaftësia qeverisëse", ka shkruar deputeti Zemaj.

Një i vdekur dhe 780 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka publikuar të enjten raportin 24-orësh të rasteve të reja me Covid-19 në Kosovë. Sipas njoftimit të

MSh-së, gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë ka ndërruar jetë një person i infektuar me Covid. Gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar edhe 780 raste

pozitive me koronavirus, ndërsa janë shëruar 1 562 qytetarë. Aktualisht në Kosovë janë 7 221 raste aktive me Covid. Ndërsa Shërbimi Spitalor,

Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka bërë me dije se aktualisht po marrin shërbime në klinika dhe spitale 77 pacientë të infektuar me koronavirus.





DREJTUESIT E SHTETIT TË KOSOVËS DHE ATA TË SERBISË E AKUZOJNË NJËRI-TJETRIN PARA TAKIMIT TË BRUKSELIT

Kurti dhe Vuçiqi replikojnë para takimit të 18 gushtit

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen në Bruksel më 18 gusht. Ky takim vjen pas tensioneve të fundit në veri të Kosovës. Para këtij takimi, Kurti dhe Vuçiqi kanë vazhduar të replikojnë nga distanca, duke shkëmbyer edhe akuza kundër njëri-tjetrit. Kurti e ka akuzuar Beogradin zyrtar se është duke tentuar ta përshkallëzojë situatën në veri në konflikt të armatosur. Ai ka thënë se barrikatadat në veri janë vendosur për shkak të lajmeve të rreme, veçanërisht në lidhje me vendimet e Kosovës për reciprocitet për targa dhe dokumentet serbe, ndërsa presidenti Vuçiq ka thënë se autoritetet e Kosovës dëshirojnë ta sulmojnë veriun dhe serbët atje

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 11 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pritet të takohen në Bruksel më 18 gusht. Ky takim do të mbahet me kërkesën e Bashkimit Evropian dhe vjen pas tensioneve në veri të Kosovës, ku serbët e instrumentalizuar nga Beogradi zyrtar në fund të muajit korrik kishin vendosur barrikada në shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për reciprocitet për targa dhe dokumentet serbe. Vendimi i qeverisë për reciprocitet pritej të hynte në fuqi më 1 gusht, por për shkak të tensionimit të situatës në veri dhe me kërkesë të ShBA-së dhe BE-së, ky vendim është shtyrë për 1 shtator. Në natën e 31 korrikut, kryeministri Albin Kurti e ka akuzuar Beogradin për vendosjen e barrikadave në veri. "Ende pa filluar lëshimi ynë i dokumenteve të hyrje-daljeve

në vendkalimet kufitare me Serbinë, strukturat ilegale serbe në veri filluan bllokimin e rrugëve dhe të shtënat me armë. Atyre u paraprinë deklaratat, takimet dhe mbledhjet e frikës dhe kërcënimit në Beograd dhe në Rashkë. Aty u planifikuan dhe u nxitën këto veprime agresive që po ndodhin sot. Vuçiqi dhe Petkoviqi janë përgjegjësit kryesorë për trazirat", kishte thënë Kurti. Më tutje, Kurti i ka akuzuar Serbinë dhe Vuçiqin se janë të varur nga Rusia. "Kur kemi parasysh kontekstin aktual të kontinentit tonë me këtë luftën e tmerrshme në Ukrainë pas pushtimit dhe agresionit rus, mund të them se shteti i Kosovës jo vetëm që është më demokratik sesa i Serbisë, por është edhe më i pavarur sesa i Serbisë. Kosova është më e pavarur sesa Serbia. Serbia është e varur prej Rusisë. Pesëdhjetë e gjashtë për qind të industrisë së naftës në Serbi i ka 'Gazpromi'. Mbi 60 për qind të Kuvendit të Serbisë janë në kuadër të Grupit

të Miqësisë Serbi - Rusi. Armatimin e kanë nga Rusia, ushtrimet ushtarake i kanë me Rusinë, lidhjet kulturore-historike janë të gjera dhe të thella. Andaj në këtë kuptim Kosova është vend shumë më i pavarur pakrasimisht sesa Serbia. Pra, ne nuk jemi vetëm më demokratik sesa Serbia, ne jemi edhe më të pavarur sesa Serbia. Ajo është e varur nga Rusia", ka thënë Kurti në një intervistë për Radion Evropa e Lirë. Kurse në një intervistë për gazetën italiane "La Repubblica", Kurti ka thënë se ekziston një rrezik i lartë për një konflikt të ri në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, ky rrezik është rritur pas sulmit të Rusisë mbi Ukrainën. "Rreziku i një konflikti të ri ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është i lartë. Do të isha i papërgjegjshëm nëse do të thosha të kundërtën, veçanërisht pasi bota ka parë se çfarë ka bërë Rusia mbi Ukrainën", ka thënë Kurti, duke shtuar se ky rrezik është më i

vogël pasi që në Kosovë praninë e saj e ka NATO-ja. "Nuk dua të them shumë i lartë, sepse ne kemi NATO-n këtu, por i lartë. Ne jemi një demokraci në kufi me një autokraci, në fund të fundit. Para pushtimit të Ukrainës mundësitë ishin të pakta, tani situata ka ndryshuar. Episodi i parë, pasojë e idesë fashiste të pansllavizmit që ka Kremlinin, ishte Ukraina. Nëse kemi një episod të dytë, për shembull në Transnistria, atëherë gjasat që një luftë e tretë të zhvillohet në Ballkanin Perëndimor, në Kosovë në veçanti, ato do të jenë shumë të larta", ka deklaruar Kurti. Po ashtu, i pari i Qeverisë së Kosovës ka ripërsëritur deklaratën e dhënë në mbledhjen e djeshme të qeverisë, ku ka theksuar rreziqet e lajmeve të rreme, veçanërisht në lidhje me vendimet për reciprocitet për targa dhe dokumente me Serbinë. Sipas Kurtit, dezinformimi i tillë ka çuar në barrikada dhe shkelje të lëvizjes së lirë në veri të Kosovës. Në lidhje me këtë, Kurti u është drejtuar qytetarëve serbë në gjuhën e tyre, ku ka thënë se Ministria e Punëve të Brendshme të gjitha informatat për vendimet e reja i ka publikuar në serbisht. "Sido që të jetë, kampanja jonë e informimit më 29 korrik rreth vendimeve të qeverisë dhe thirrja jonë për ta respektuar ligjin ishte përballur nga një kampanjë që synim kishte dezinformimin publik, nxitjen e frikës dhe destabilizimit", është shprehur Kurti.

Vuçiqi: Kurti po i gënjen vendet e Quint-it

Ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nga Beogradi ka deklaruar se Prishtina është ajo që dëshiron ta sulmojë veriun e vendit. Ai ka pretenduar se Kosova po e përdor situatën në Ukrainë për të bërë fushatë kundër Serbisë dhe se, sipas tij, "është gënjeshtër se Serbia dëshiron të sulmojë këdo". "Kosova po përgatit likuidimin e popullit tonë nën petkun e luftimit të krimit, prandaj i paralajmëroi që të mos e bëjë fare këtë", ka thënë ai, raporton "Tanjug"-u. Duke komentuar deklaratën e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, se Beogradi po ndjek një politikë agresive me akuza se Beogradi mund të shkaktojë konflikt, Vuçiqi ka thënë se "kjo është disi qesharake, sepse kemi 170 ditë që dëgjojmë gënjeshtër të ngjashme". Më tutje, Vuçiqi ka thënë se nuk pret ndonjë rezultat nga takimi me Kurtin në Bruksel. "Po shkoj në Bruksel për të biseduar, nuk shpresoj për ndonjë rezultat, por po shkoj për bisedime", ka thënë Vuçiqi të enjten. Vuçiqi ka deklaruar për mediet serbe se beson se pala e Kosovës tashmë e ka konfirmuar se është duke e imponuar vullnetin e vet. "Atyre nuk u intereson se çfarë do të thotë Beogradi, kështu që unë as nuk e di se për çfarë është dialogu. Ata që deklaruan se duhet të bisedohet për Asociacionin e Komunave me

Luftë në Kosovë, e kush do ta bëjë këtë luftë?!



Shkruan Behxhet SHALA-BAJGORA

Uroj që Kina të mos e sulmojë Tajvanin: Kosova qenka në rrezik nga Serbia e cila, në fakt është vetëm mjet për ta destabilizuar vendin tonë, me urdhër të Ruisë dhe Vladimir Putin! Këtë nuk e kanë ditur as shërbimet më të fuqishme zbuluese dhe kundërzbuluese por, pas analizave, këtë e bën publike kryeministri Albin Kurti dhe presidentja Vjosa Osmani. Si Papë Françesku që i drejtohet besimtarëve në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan me enciklikën e tij, urbi et orbi, edhe kryeministri Kurti e shfrytëzoi një medium italian, tash edhe një anglez që përmes një interviste ta informojë opinionin ndërkombëtar se lufta në Kosovë vetëm se nuk paska filluar dhe se përgjegjësinë për këtë e kanë Aleksandër Vuçiq, president i Serbisë dhe Vladimir Putin, president i Ruisë. Bota këtë e mori shumë seriozisht, më seriozisht se vet luftën në Ukrainë. Kurrë dhe asnjëherë Kosova nuk ka qenë më e gatshme, ushtarakisht dhe politikisht për luftë se që është tani. E kemi një kryeministër që nga Ballkoni i Hapur dhe duke hëngër shtalba i mbikëqyrë operacionet ushtarake. Ndonëse nuk ka përvojë ushtarake, ka përvojë të madhe politike dhe është njohës i mahnitshëm i doktrinave luftarake. Sun Tzu, Monteskie, Makiavelli, gjenerali Gjap dhe strategët e tjerë ushtarakë të cilët i pranon bota si autoritete të jashtëzakonshme në këtë fushë, janë thuaja amatorë krahasuar me kryeministrin tonë. Pastaj,

kryekomandantja e forcave të armatosura të Kosovës, presidentja Vjosa Osmani ka përvojë të gjatë luftarake, që nga fillimi ka luftuar me të gjitha mjetet e lejuara dhe aspak të lejuara udhëheqësit kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët, ndonëse po mbahen peng në Gjykatën Raciste në Hagë, ende po sulmohen nga kryekomandantja deri në çastin kur në nuk do të paraqesin rrezik për këta trashëgimtarë të lirisë që me asgjë nuk e kanë merituar. Zëvendësuesja e saj, Donika Shvarc (Katran) ka përvojë edhe më të gjatë në luftën kundër ish të burgosurve politikë, bacës Adem Demaçi dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Madje, botërisht pati deklaruar se nëse kërkohet nga ajo do të dërgojë dosje edhe në Gjykatën e Hagës, nëse nuk i ka dorëzuar deri më tani. Jo në mbrojtje të tyre, sigurisht. Nëse këta tre që i përmenda më lartë vetëm 10 për qind do ta urrenin Serbinë dhe Rusinë krahasuar me urrejtjen që e kanë ndaj udhëheqësve të UÇK-së, pavarësisht a janë të burgosur apo në "liri", as Serbia e as Rusia as që do të nisnin luftë kundër Kosovës dhe shqiptarëve. Këta që po trumpetojnë se do të ketë luftë me Serbinë dhe Rusinë, e kanë lepurin në bark dhe sot e 500 vjet nuk do të luftonin për asgjë, përjashtuar për karriget e pushtetit. Nëse e bëjmë një shëtitje, mbase edhe sipërfaqësore të emërimeve në borde të ndryshme, në misione diplomatike dhe konsullare, poste ministrorë dhe në nivele më të ulëta të pushtetit, atëherë me lehtësi konstatojmë se asnjë qeveri e mëparshme nuk ka numër aq të madh të ish-bashkëpunëtorëve të Jugosllavisë, Serbisë, UDB-së dhe shërbimeve tjera, sa ka qeveria aktuale. Janë krejtësisht të kastruar nga patriotizmi, qoftë edhe deklarativ. Madje, për ta vërtetuar atë që e thash më lartë, kemi shumë fakte dhe shkarkime që kanë ndodhur kohëve të fundit

pikërisht ndaj të merituarve për lirinë që aktualisht po e përdorin për mbajtje të pushtetit, pasi e përdorën paraprakisht për marrje të pushtetit, madje duke shfaqur një ekzaltim patologjik. Kemi rastin kur trashëgimtari biologjik i një ish-bashkëpunëtori të sigurimit jugosllav dhe serb është zgjedhur në një bord shumë të rëndësishëm, ndërsa një ish i burgosur politik, viktimë e dhunës të atij bashkëpunëtori ishte eliminuar. Merreni një tablo të mozaikut të punësimit në vende të ndjeshme, në institucione të ndjeshme dhe do ta shihni se pikërisht fëmijët e spiunëve janë emëruar ambasadorë, anëtarë të bordeve, zëdhënës, këshilltarë politikë kurse fëmijët e ish të burgosurve politikë dhe të ish-ushtarëve të UÇK-së, bëjnë punë krahu, punojnë nëpër kafiteri apo kërkojnë rrugë të shkojnë në vende tjera. Ose, nëse rastësisht dikush prej tyre është në ndonjë vend të rëndësishëm e që pushteti aktual i konsideron armiq prindërit e tyre, i bien gurit dhe drurit deri sa t'i largojnë nga puna. Këso hakmarrje dhe linçim nuk ka pasur në asnjë regjim. Në qeverinë aktuale ka aq urrejtës të mëdhenj të UÇK-së, të burgosurve politikë, të burgosurve që po mbahen peng në Gjykatën Raciste në Hagë, të veteranëve të luftës së UÇK-së e që do ua kishin zili edhe Shesheli dhe çetnikët e Vojë Peçancit. Së paku sipas deklaratave publike që i kanë bërë dhe po i bëjnë. Askujt prej tyre për këto deklarata nuk iu mungon as edhe një qime e vetme e lëre më të thirren në përgjegjësi. Madje, këta janë të përkëdhelurit e kryeministrit dhe të presidentes Vjosa Osmani. Sa më shumë që kanë punuar paraardhësit kuislingë të këtyre kuadrove qeveritare kundër Kosovës, Shqipërisë dhe interesave kombëtare, aq më lartë janë të ranguar dhe kanë qëndrueshmëri më të madhe në ruajtje të pozitës që e kanë, pasardhësit e tyre! Përpara, kur

botërisht e përkrahja Albin Kurtin dhe kur linçohesha botërisht nga ndërkombëtarët dhe këta kuislingët politikë dhe joqeveritarë që po mrizojnë nën flladin dhe kujdesin e plotë të Albinit, as në ëndërr nuk kam menduar se do të vijë një kohë kur Albini do të transformohej aq shumë, në kuptimin negativ, pa asnjë dyshim. Albin Kurtin e ka bërë Albin Kurti, baca Aden Demaçi, shiheni sot qëndrimin e Binit për Bacën?! E keni dëgjuar ta ketë përmendur përveçse kur kthehej nga vizita e varrit, të cilin për së gjalli as që e bënte llogari! Jam i sigurt dhe koha ma ka vërtetuar se çdonjëri që është fërkuar për bacën Adem Demaçi, në kohën më të keqe për të i kanë ardhur faturat të cilat nuk ka pasur mundësi t'i shlyej. Nuk kanë qenë fatura të drejtësisë apo hakmarrjes tokësore por fatura të drejtësisë hyjnore! Kush do të jetë gjallë, do të bindet, sigurisht! Të gjithë ne që kemi besuar se Kosova ka nevojë për ndryshim, kemi pasur të drejtë. Mirëpo, në asnjë çast nuk kemi besuar dhe nuk duam të besojmë se ky ndryshim është ai të cilin e kemi pritur. Nuk kemi besuar se rinia, në vend që të shkrijë mend dhe mund në Kosovë, po e bënë të pamundurën të ikë nga Kosova. Nuk kemi besuar se ende duhet të skuqemi, turpërohemi dhe të ndjehemi fajtorë para fëmijëve të kuislingëve të policisë serbe, të UDB-së, prokurorisë dhe gjyqësorit e që sot mbajnë pozita të rëndësishme në institucione ndonëse edhe sot i bartim pasojat e torturave nga ta. Thuaja si çdo qeveri e mëparshme, edhe qeveria Kurti 2 po e blenë dëgjueshmërinë me poste, nepotizëm, korrupsion, tash në sasi shumë më të madhe sepse edhe numri i votave ishte shumë i madh e që, përkthyer në përqindje, ka pushtet absolut.

Si do të dukej lufta e ardhshme: Fillimisht jam i sigurt se nuk do të ketë luftë sepse nuk ka kush të

luftojë. Në pushtetin aktual ata që e "hanë hekurin me dhëmbë" numërohen me gishta të një dore, saktësisht këta janë: Dimali, Hakiu, Haxhi Qamili, Hekurani dhe ... kush tjetër?! Këta që po flasin për luftë e kanë të qartë që për aq kohë sa në Kosovë do të valëvitet edhe një uniformë e vetme e NATO-s, Serbia nuk e mësynë Kosovën prandaj edhe po i bien trumbetave të luftës. Në fakt, këtyre "shqipeve" pa sqep dhe pa kthetra, më mirë do t'u shkonte muzika me trumbetë "Il Silenzio" nga Nino Rossi që përdoret si ninullë për t'i vënë ushtarët në gjumë! Edhe në rastin më të skajshëm kur bashkësia ndërkombëtare do të vendoste të tërhiqej nga Kosova e që nënkupton se Serbisë do t'i jepeshin duart e lira për veprim, luftën do ta bënin ata që e bënë luftën e fundit të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, pasardhësit e tyre sikur edhe pasardhësit e ish të burgosurve politikë. Këta janë sakrifikuar që nga dita e parë e rezistencës kombëtare, deri në kohën kur u fitua një liri gjysmake. Një numër i patriotëve të Shtalbit të Përgjithshëm të Ushtrisë Virtuale të pushtetit aktualë, luftën do ta bënte nga Norvegjia, Gjermania, Anglia, Zvicra, Italia dhe Greqia kurse, një numër jo i vogël si vazhdimësi e traditës familjare, luftën do ta bënin nga Serbia. Këto kombinime mund të bëhen vetëm pasi do të përfundojë lufta në Ukrainë dhe pasi Rusia dhe Putini të marrin dënimin e merituar nga kryeministri Kurti dhe Vjosa Osmani, presidente shëtitëse, sikur holandezja e fjetur! Uroj sinqerisht që Kina të mos e sulmojë Tajvanin sepse do të dilte një angazhim shtesë për Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin, do të detyrohen të mobilizohen në mbrojtje të Tajvanit dhe në luftë kundër Kinës. Punë e vogël kjo, do të luftonin kundër 1 miliard e 500 milionë kinezëve. Angazhim i papërfillshëm, fare! Zot, qo mend aty ku nuk ka!

Shumicë Serbe, si dhe duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, më lejoni që t'i pyes ata se a po bëjnë shaka? Çfarë kemi negociuar?", ka thënë Vuçiqi. Po ashtu, Vuçiqi ka thënë se beson se Kosova do të jetë në agjendën e Kuvendit të Serbisë gjatë muajit shtator. "Besoj se në shtator Kuvendi do ta analizojë situatën me 'Kosovën dhe Metohinë'. Ky është obligimi ynë. Qytetarët duhet të dëgjojnë se cili është obligimi ynë dhe shpresoj që arsyeja të mbizotërojë", ka thënë ai, duke shtuar se ka informacione për plane lidhur me veriun e Kosovës. "Kërkesa ime për shtetet e Quint-it është që të mos e bëjnë këtë, Kurti të mos i gënjejë ata. Nuk ka pasur të

shtëna në veri, nuk do të lejojmë askënd që të hapë zjarr ndaj ushtarëve dhe policëve tanë në Serbinë qendrore, madje as ndaj NATO-s. Unë u kërkoj që të mos synojnë të bëjnë diçka të tillë", ka thënë Vuçiqi, duke mos specifikuar se çfarë planeve po i referohej. Presidenti serb i ka quajtur të rreme akuzat për interesimin dhe përfshirjen e Ruisë në situatën në Kosovë. "Ata përmendin Rusinë, madje (zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse) Maria Zakharova tha se ne nuk kemi kërkuar ndihmë. Çfarë tjetër po shpikin? Ne e kemi shtetin dhe Kushtetutën tonë dhe të drejtën ndërkombëtare në anën tonë", është shprehur Vuçiqi.

Takimi Kurti - Vuçiq, pritet të nënshkruhet një deklaratë e përbashkët për personat e pagjetur

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen më 18 gusht në Bruksel. Në këtë takim pritet të nënshkruhet një deklaratë e përbashkët për zgjidhjen e çështjes së personave të pagjetur, raporton gazeta serbe "Nova". Agjenda ende nuk dihet për publikun, derisa pala serbe pret që në Bruksel të diskutohet për targa e veturave dhe dokumentet e identifikimit. Siç shkruan gazeta, kjo është një çështje e kthyer për Prishtinën. Sipas gazetës

"Nova", nënshkrimi i kësaj deklaratë pritet të jetë në rendin e ditës në Bruksel dhe konsiderohet hap i madh në marrëdhëniet mes dy palëve. Ndërsa kryetari i Komisionit të Qeverisë së Serbisë për Personat e Zhdukur, Veljko Odaloviq, ka thënë se nënshkrimi i kësaj deklaratë ishte diskutuar edhe në raundet e mëparshme. Odaloviq ka thënë se për tekstet në masë të madhe janë pajtuar, por se ka pasur kërkesë edhe nga Prishtina.

Interesim i madh për dru të zjarrit

PRISHTINË, 11 GUSHT - Për shkak të frikës se mund të ketë shkurtime të energjisë elektrike, por edhe rritje të çmimit, familja Beka nga Prishtina ka vendosur që këtë dimër të ngrohet me stufë me dru zjarri. Adelina Beka, rreth të 30-tave, ka treguar për "Radion Evropa e Lirë" se familja e saj gjashtanëtarëshe, që jeton në lagjen "Kolovica" të kryeqytetit të Kosovës, për vite me radhë ishte ngrohur me energji elektrike. "Për gjashtë vjet në shtëpi kemi pasur ngrohje me rrymë. Sivjet kemi blerë një stufë dhe drutë e zjarrit. Nuk e di sa metra kemi blerë, por e di që 50 euro ka kushtuar metri. Drutë i kemi blerë në muajin maj. Do të jetë sfidë sepse me ngrohëse elektrike i kemi ngrohur të gjitha dhomat e shtëpisë, tashmë duhet vetëm një", ka thënë ajo.

Paralajmërimet për një dimër "shumë të pasigurt"

Dyfishimi i çmimit të energjisë në berëzat ndërkombëtare gjatë korrikut, por edhe kapaciteti i kufizuar për prodhim të brendshëm, i kanë shtyrë autoritetet e Kosovës që të bëjnë thirrje për kursim të energjisë. Më 27 korrik Kompania për Distribuimin e Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) ka paralajmëruar një dimër "shumë të pasigurt", kurse më 9 gusht ka kërkuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) shtrenjtimin e tarifave të rrymës.

Më 8 shkurt të këtij viti ZRRE-ja tashmë ka miratuar tarifa më të shtrenjta të rrymës që u tha se do të jenë në fuqi deri më 31 mars të vitit të ardhshëm. Ky shtrenjtim, megjithatë, ka prekur vetëm ata konsumatorë që shpenzojnë mbi 800 kilovatë në orë gjatë një muaji.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me dy termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B", mund të prodhojë energji deri në 800 megavatë në orë, kurse nevojat e konsumatorëve, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavatë në orë. Diferenca tjetër sigurohet nga importi. Sipas ZRRE-së, Kosova vitin e kaluar ka importuar 1 311 461 megavatë rrymë.

Përveç ngritjes së çmimit, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka deklaruar se gjatë muajve të ardhshëm është e pritshme që disa nga shtetet e Evropës ta ndalojnë eksportin e lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike. Sipas vlerësimeve të Institutit për Politika Zhvillimore në Kosovë (INDEP), gjatë sezonit të dimrit 75 për qind e konsumit të rrymës shpenzohet për ngrohje.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mbi 50 për qind e sektorit të amvisërisë



shfrytëzojnë biomasë (dru zjarri dhe pelet), kurse energjia elektrike më shumë shpenzohet nga sektori i biznesit dhe ai i shërbimeve. Se interesimi i qytetarëve për të blerë dru për ngrohje është rritur, e konfirmon shitësi i këtij produkti në Prishtinë, Jakup Halili, rreth të 60-tave. Por, po ashtu, ai thotë se edhe çmimet janë rritur. "Interesimi është tepër i madh sepse nuk ka siguri për rrymë. Nuk ka alternativa dhe njerëzit nuk kanë çare pa blerë dru. Gjatë një dite shiten deri në 50 metra dru, shumë më shumë se në vitet e tjera", thotë Halili, duke shtuar se një metër dru sivjet po shitet për 60 deri në 70 euro, ndërkaq vitin e kaluar çmimi ishte rreth 40 euro.

Cilat janë alternativat?

Përderisa disa qytetarë po zgjedhin të ngrohen me dru, nga rreziku i mungesës së rrymës, disa të tjerë nuk kanë alternativa për shkak se jetojnë në banesa kolektive.

Një ndër ta është profesori i pensionuar Adem Berisha, i cili së bashku me bashkëshorten jeton në një banesë në Prishtinë. "Në banesë, përveç rrymës, nuk ka zgjidhje tjetër, pasi banesa oxhak nuk ka. Do të blej ndonjë radiator që shpenzon rrymë më pak, ose ndonjë aparat ngrohës që akumulon rrymën natën dhe e shfrytëzojmë ditën. Tjetër nuk di çka të bëj", thotë ai.

Alternativë tjetër për qytetarët është ngrohja përmes djegies së peletit, por edhe kjo lëndë djegëse është shtrenjtuar. Vitin e kaluar një ton pelet ka kushtuar rreth 200 euro, ndërkaq sivjet çmimet po variojnë nga 300 deri në 400

euro, varësisht nga dyqani dhe rajonet ku shitet ky produkt. Peleti përdoret për ngrohjen e banesave që kanë të instaluar kaldaja për këtë lëndë djegëse. Por, pavarësisht rritjes së çmimit, në treg ka mungesë të peletit. Bashkim Zejnullahu, pronar i kompanisë së prodhimit të peletit "Thes-Ari" në komunën e Vitisë, thotë se aktualisht ka ndërprerë shitjen e këtij produkti për konsumatorë dhe po prodhon vetëm për kompanitë që kanë nënshkruar më herët kontrata. Sipas tij, kërkesa e konsumatorëve për pelet është shumëfish më e lartë se në vitin e kaluar. Vlera e importit të këtij produkti gjatë vitit 2021 dhe sivjet ka arritur në rreth 9 milionë euro dhe për shkak të rritjes së çmimit, autoritetet në Kosovë kanë paralajmëruar vendosjen e një çmimi tavan.

Si mund të ngrohen shtëpitë?

Organizatrat joqeveritare që merren me sektorin e energjisë thonë se për të pasur një dimër të përbalueshëm, autoritetet kompetente duhet të nisin t'i subvencionojnë burimet alternative për ngrohje. Eksperti i politikave të energjisë në INDEP, Dardan Abazi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se heqja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) për panelet solare, për pelet, subvencionimi i paneleve diellore dhe pompave të ngrohjes për bizneset dhe familjet, do të ndihmonte që konsumatorët ta kalojnë më lehtë dimrin. Ai ka shtuar se favorizimi i peletit për ngrohje dhe subvencionimi i kësaj lëndë djegëse do ta zvogëlonte kërkesën për ngrohje me

rrymë. Aktualisht, rreth 94 për qind e energjisë elektrike në Kosovë prodhohet nga djegia e thëngjillit, ndërsa rreth 6 për qind nga burimet e ripërtërishe, si: hidrocentralet, centralet me erë dhe panelet me diell. Në rast të mungesës së rrymës gjatë dimrit, që shtëpitë të jenë të ngrohta, duhet investuar edhe në izolimin e tyre, por edhe në pompa termike apo kaldaja qendrore për ngrohje. Por, për të gjitha këto qeveria duhet të ndajë një shumë të granteve, ka thënë Hamdi Malushaj, drejtor në kompaninë "Evroenergie", kompani kjo që merret me analiza dhe studime të çështjeve energjetike në tregun e Kosovës dhe Gjermanisë.

Pompat termike janë pajisjet kryesore të radiatorëve që shërbejnë për ngrohje. Këto pompa konsumojnë më pak energji elektrike. Por, Malushaj ka thënë se është e vështirë që vetë qytetarët ta zgjidhin këtë problem. Përveç shpenzimit të rrymës, sipas tij, ata duhet të sigurojnë dru zjarri ose pelet dhe këto paraqesin kosto shtesë.

Gjithashtu, lëndët djegëse kontribuojnë edhe në ndotjen e ajrit.

"Qeveria duhet të veprojë shpejt në dhënien e mjeteve financiare në formë të granteve për izolimin e shtëpive", ka thënë Malushaj, duke shtuar se një pjesë të parave do të duhej ta financonte qeveria dhe pjesën tjetër vetë qytetarët. "Mund të hiqet edhe TVSh-ja për pompat termike, taksat doganore, në mënyrë që të kemi një dimër më të butë. Jemi vonë për të marrë vendime të sigurta, por për t'i zvogëluar pasojat ka ende hapësirë", ka thënë ai.

Në vitin 2018 mbi 43 për qind e ekonomive familjare nuk kanë mundur t'i ngrohin shtëpitë e tyre në mënyrë adekuate, thuhet në të dhënat e ASK-së. Ndërsa në raportin e fundit të iniciativës rajonale "Balkan Green Foundation" thuhet se "afër një e katërta e familjeve në Kosovë kanë problem me izolimin bazë në shtëpitë e tyre. Nga kjo shifër 22 për qind e familjeve kanë problem me çati, mure, dysheme që rrjedhin, themele të lagura, korniza të dritareve dhe dysheme të kalbura.

Cilat produkte ngrohëse do t'i subvencionojë qeveria?

Në mes të paralajmërimeve për një dimër shumë të pasigurt, më 4 gusht Qeveria e Kosovës miratoi disa masa emergjente për furnizimet me rrymë. Në këto masa përmendet mbështetja për qytetarët me qëllim të sigurimit të ngrohjes gjatë dimrit. Por, nuk përmenden konkretisht se për çfarë masash bëhet fjalë.

REL-i ka pyetur Ministrinë e Ekonomisë se cilat do të jenë masat mbështetëse për qytetarët, por deri në publikimin e këtij teksti nga ky institucion nuk ka kthyer përgjigje.

Megjithatë, ministrja Rizvanolli, pas mbledhjes së qeverisë më 10 gusht, ka thënë se ekzekutivi do t'i subvencionojë pompat termike, stufat me pelet, teksa vëmendje e veçantë do t'u kushtohet familjeve që marrin ndihma sociale, duke subvencionuar edhe ngrohjen me dru zjarri. "Kjo listë e masave në ditët në vijim do t'i dërgohet Ministrisë së Financave, për t'i parë mundësitë e financimit se në çfarë mase do të mund të financohet", ka thënë Rizvanolli, duke shtuar se vendin po e pret një dimër i vështirë.

Mënyrat e kursimit

Për shkak të shtrenjtimit të tarifave dhe nevojës për kursimin e rrymës, ZRRE-ja më herët gjatë vitit doli edhe me disa rekomandime. "Aktivizimi i makinave për larjen e rrobave, si dhe i atyre për larjen e enëve gjatë natës, me tarifa të ulëta, është vetëm një nga metodat për kursim", thuhet në një prej rekomandimeve të ZRRE-së.

Ky institucion, po ashtu, ka rekomanduar që akumulimi i nxehtësisë nga termot ngrohëse të bëhet gjatë natës, kur tarifat e rrymës janë të ulëta, ndërkaq bojleri të përdoret vetëm atëherë kur nevojitet. Lëvizja e çmimeve të rrymës fillimisht ka nisur për shkak të pandemisë së koronavirusit, por gjendja është përkeqësuar edhe më shumë pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës në fund të shkurtit, që ka bërë që kriza energjetike të kaplojë të gjithë botën.

Qeveria do të punësojë persona me aftësi të kufizuara

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, kanë mbajtur të enjten një takim me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare (OJQ) ku, ndër të tjera, janë nënshkruar edhe disa marrëveshje të bashkëpunimit për zbatimin e masës 1.6 - Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara të pakos së ringjalljes ekonomike në mes të qeverisë dhe OJQ-ve. Me këtë rast, Kurti ka dhënë

hollësi për zbatimin e masës 1.6. "Kjo masë, që e kemi dizajnuar së bashku, synon të arrijë dy objektiva: e para, nxënien e shkathtësive nga personat me aftësi të kufizuara dhe, e dyta, punësimin e qëndrueshëm të tyre. Nxënien e shkathtësive është e destinuar që të rezultojë me punësim. E për të nxitur dhe mundësuar punësim të garantuar dhe të qëndrueshëm, ne zotohemi që bizneseve që lidhin kontratë të rregullt pune me personat që kanë ndjekur trajnimet, t'ua

subvencionojmë pagën e punëtorit deri në 270 euro në muaj, për 6 muaj me radhë. Pra 270 euro për gjashtë muaj me radhë, që i bie më shumë sesa niveli bruto i pagës minimale, të cilën e kemi kaluar tashmë në lexim të parë në Kuvendin e Republikës", thënë Kurti. Ndërsa ministri Hekuran Murati ka thënë se, ndonëse masat e pakos kanë qëllim të krijojnë prosperitet për të gjithë, ato shpeshherë janë edhe të targetuara. Ai ka theksuar se masa 1.6 ka një



mekanizëm të veçantë duke identifikuar sfidat dhe zbatimin ku organizatat kanë arritjet përgjatë vijueshmërisë së masës. rol thelbësor në monitorim

Izraeli dhuron 70 karroca për personat me aftësi të kufizuara

PRISHTINË, 11 GUSHT - Izraeli për herë të dytë ka shpërndarë 70 karroca për personat me aftësi të kufizuara. Këto karroca do t'u shpërndahen fëmijëve në Prishtinë, por edhe qendrat e tjera të Kosovës.

Ceremonia e shpërndarjes është mbajtur në shoqatën "Hendikos", ku drejtori i kësaj shoqate, Afrim Maliqi, ka thënë se personat me aftësi të kufizuara nuk marrin asnjë shërbim institucional, përpos atyre social nga OJQ të ndryshme.

Maliqi ka thënë se presin përkrahje në përmirësim të kuadrin ligjor për personat me aftësi të kufizuara. "Këto karroca do t'u shërbejnë fëmijëve me aftësi të kufizuara si në Prishtinë, por edhe gjithandej Kosovës. Sot personat me aftësi të kufizuara, si fëmijët dhe të rriturit, nuk marrin as pajisje ndihmëse as shërbime të tjera institucionale, përpos shërbimeve sociale nga organizatat e ndryshme



joqeveritare, edhe ndonjë mbështetje financiare që e marrin si kompensim mujor për mbulimin e shërbimeve të tyre ditore. Personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre janë grupi më optimistë, përkundër asaj që janë grupi më i varfër dhe rrezikuar në vendin tonë", ka thënë ai. Sipas tij, personat me aftësi të kufizuara ballafaqohen me mungesë të infrastrukturës së përshtatshme për të lëvizur lirshëm. "Gjithsesi do të mundohemi të bashkëpunojmë edhe me klinikat e pediatrikë në spitalet regjionale sepse sigurisht edhe aty do të kenë nevojë që fëmijët

sa të jenë të shtrirë aty me qëllim të lehtësimit të lëvizjes më të lirë dhe më të lehtë, por gjithsesi kur flasim për lëvizjen e lirë, vendi ynë ende ballafaqohet me mungesën e infrastrukturës apo qasjen e duhur dhe të përshtatshme që personat me aftësi të kufizuara apo përdoruesit e karrocave të jenë të barabartë me lëvizjen e lirë, edhe pse këtu ka një lëvizje, por ende po shpresojmë që duhet të rregullohet më tutje", ka thënë Maliqi.

Ndërsa ambasadorja e Izraelit në Kosovë, Tammy Ziv, ka thënë se këto karroca që shteti i saj i ka dhuruar për qytetarët e Kosovës me aftësi të kufizuara, janë simbol i miqësisë në mes të dy vendeve. Ajo ka thënë se shpreson se me përdorimin e këtyre 70 karrocave do të lehtësohet jeta e këtyre personave. "Këto karroca janë simbol i miqësisë në mes të vendeve tona dhe simbol i rëndësisë që ne në Izrael ua japim marrëdhënies me

Kosovën. Është gatishmëria jonë për t'i forcuar këto lidhje, jo vetëm me qeverinë, por me popullin dhe fëmijët e këtij vendi. Ministri izraelit i Bashkëpunimit Rajonal, Esawi Frej, i cili vizitoi Kosovën në muajin prill, dhe besoi se investimet më të rëndësishme janë ato të fëmijët, te të rinjtë dhe në edukimin e tyre, sepse këto investime sigurisht se do t'i kthejnë të arriturat. Besojmë se me këto karroca jeta e tyre do të bëhet pak më e lehtë dhe ata do të mund të integrohen më mirë në jetën e përditshme. Ne do të punojmë së bashku me ju për të zhvilluar projekte të tjera bashkëpunimi në dobi të fëmijëve dhe familjeve të tyre", ka thënë ajo.

Në ceremoninë e dhurimit të karrocave nga shteti izraelit ka marrë pjesë edhe ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, i cili ka thënë se si qeveri po punojnë që të gjitha politikat e tyre ta lehtësojnë jetën e qytetarëve pa dallim. "Jemi

shumë të lumtur që 70 fëmijë të Kosovës në regjionet të ndryshme të Kosovës do të kenë mundësi të përfitojnë nga këto. Në takimin e parë këtu në prill patëm edhe kompaninë e cila e ka bërë donacionin e cila shpjegoi për specifikat e karrocave. Shumë i lumtur për këtë bashkëpunim me juve, shumë i lumtur për bashkëpunimin me Izraelin dhe vizita e parë e ministrit izraelit në Kosovë ishte këtu dhe filluam bashkëpunimin me një kujdes të veçantë të personave me nevojë speciale të veçanta dhe si shtet këtë vit e kemi shpallur vitin e personave me nevojë të veçanta dhe do të angazhohemi edhe si qeveri që të gjitha politikat tona të shkojnë në drejtim të lehtësimit të jetës së qytetarëve pa asnjë dallim të çfarëdo lloji", ka thënë ministri Krasniqi. Izraeli edhe gjatë muajit prill të këtij viti i ka dhuruar Kosovës 93 karroca, gjatë vizitës së ministrit për Bashkëpunim Regjional të Izraelit, Esawi Frej në Kosovë.

Gjermania dhe Kosova nënshkruajnë marrëveshje mbi varret gjermane të luftës në Kosovë

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde dhe ministri e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla-Schwarz, kanë nënshkruar marrëveshjen gjermano-kosovare mbi varret gjermane të luftës në Republikën e Kosovës.

Me këtë marrëveshje synohet të vendoset një rregullim përfundimtar për varret gjermane të luftës që ndodhen në territorin sovran të Republikës së Kosovës dhe të sigurohet ruajtja dhe mirëmbajtja e këtyre varreve në mënyrë të denjë dhe sipas dispozitave të së drejtës humanitare ndërkombëtare në fuqi.

Për të arritur këtë Republika Federale e Gjermanisë, ndër të tjera, e ka mundësinë t'i

mirëmbajë varret gjermane të luftës dhe varrezat gjermane të luftës në Republikën e Kosovës me shpenzimet e veta, t'i përqendrojë në një vend varret e të vdekurve gjermanë të luftës dhe të realizojë zhvarrosjen dhe zhvendosjen e nevojshme për këtë, si dhe të ndërtojë përmendore në një formë të thjeshtë dhe të denjë në vendet e këtyre varrezave, në të cilat zhvarrosja e të vdekurve gjermanë nuk është më i mundur. Më mënyrë përkrahëse, Republika e Kosovës zotohet, ndër të tjera, për mbrojtjen e varreve gjermane të luftës dhe garantimin e prehjes së përhershme për të vdekurit gjermanë të luftës në territorin e saj sovran, si dhe për lënien në dispozicion pa shpenzime

të trojeve që shërbejnë si varreza gjermane të luftës. Me zbatimin e detyrave do të ngarkohet lidhja kombëtare për ruajtjen e varreve gjermane të luftës (Volksbund), së cilës Republika e Kosovës i siguron mbështetje gjithëpërfshirëse gjatë realizimit.

Lidhur me këtë, sekretari i përgjithshëm i Volksbundit ka deklaruar: "Jemi të lumtur që puna jonë në Kosovë tashmë ka marrë një formë kontraktuale dhe mund të fillojë. Ne kemi njoftime të hapura për rreth 900 vendvarrime, të cilat do t'i shqyrtojmë në muajt dhe vitet në vijim. Për këto operacione ne e kemi trajnuar personelin tonë. Aktualisht jemi njoftuar për gjetje të eshtrave në një vend afër Stanovcit që do ta



ekzaminojmë. Me anë të kësaj bëhet e mundur që më shumë se 75 vjet pas luftës të sqarohet identitetin e të vdekurve dhe t'i njoftojmë familjet lidhur me fatin e tyre. Ky vërtetë është një zhvillim i mirë për të ardhmen". Pas nënshkrimit, marrëveshja tani u nënshtrohet

procedurave përkatëse kombëtare për ratifikim. Ambasadori Rohde e ka falënderuar ministren Gërvalla-Schwarz për nënshkrimin e marrëveshjes, duke e vlerësuar atë si vetëm një tjetër hap drejt forcimit të marrëdhënies kosovaro-gjermane.

Diaspora, blerësja më e madhe e patundshmërive

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Diaspora e zë vendin më të lartë të investimeve të huaja. Këto investime kryesisht bëhen në patundshmëri. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), investimet e huaja direkte në vitin 2021 kanë pasur vlerën e mbi 400 milionë eurove. Nga to 380 milionë shkojnë në sektorin e patundshmërive.

Investimet e huaja në sektorin e patundshmërisë, sipas BQK-së, pothuajse dyfishuan pjesëmarrjen nga 58.2 për qind në 92.6 për qind në vitin 2021. Por, ky mekanizëm financiar ka parashikuar se sektori i ndërtimit dhe i patundshmërive do të përballlet me probleme financiare për shkak të rritjes së kostove të produkteve dhe

pasigurisë në lëvizjen e çmimeve. Sipas këtij institucioni, në tremujorin e tretë të këtij viti, përkeqësimi i situatës në sektorin e ndërtimit dhe patundshmërive do të jetë më evident për shkak të pasigurive rreth sjelljes së diasporës kosovare dhe efektit të tyre të lartë në ekonominë e vendit.



Rama: Pa llogaritur vëllezërit dhe motrat nga Kosova kemi rritje të turizmit



TIRANË, 11 GUSHT - Shqipëria ka rritje të numrit të turistëve këtë vit, ka thënë kryeministri Edi Rama, i cili është shprehur se tashmë, pa llogaritur vizitorët nga Kosova, shifrat janë të qarta se bëhet për një vit të suksesshëm në turizëm. Rama ka thënë se në muajin qershor ka pasur rritje të turistëve për 45 për qind në Shqipëri, pa përfshirë shtetasit kosovarë. “Ne kishim një turizëm të brendshëm dhe një industri inekzistente turistike që mbahej në këmbë vetëm dhe ekskluzivisht nga motrat dhe vëllezërit tanë në Kosovë. Unë kam marrë shifrat e këtij viti që flasin më qartë sesa çdo fjalim për vizitorët e huaj, duke përjashtuar vizitorët nga Kosova, të cilët tanimë hynë të paregjistruar për shkak se

kemi hapur kufirin që nga 1 qershori dhe hyrja nga Kosova është si hyrje nga Shkodra për në Vlorë, njësoj. Në qershor kemi pasur 604 mijë turistë, përfshirë dhe turistët nga Kosova. Sot kemi 876 mijë turistë të huaj, pasaporta të huaja, as të Shqipërisë, as të Kosovës, 45 për qind qershori”, ka thënë Rama. Duke dhënë shifrat për muajin korrik, Rama ka treguar se kanë hyrë 1.4 milion të huaj, sërish papërfshirë personat me pasaportë të Kosovës. Ai është shprehur se Tirana zë vendin e dytë pas Antalisë për rritjen më të lartë të turizmit në gjithë zonën e Mesdheut. “Në korrik kemi pasur 1.1 milion, sot kemi 1.4 milion pasaporta të huaja, as nga Shqipëria, as nga Kosova dhe në këtë

periudhë, 1 deri në 10 apo 7 gusht, 411 mijë vjet, 482 mijë sivjet dhe në një nga klasifikimet e bëra për vendet me rritjen më të lartë të turizmit në gjithë zonën e Mesdheut, Tirana zë vendin e dytë mbas Antalisë në rritje relative kuptohet në raport me vetveten”, ka thënë Rama pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet “Eagle Hills Real Estate Development”, përfaqësuar nga investitori Muhammed El Alabbar dhe “Albanian Seaports Development Company”, për realizimin e projektit “Durrës Yachts & Marina”, portit më të madh turistik të Mesdheut në Durrës. Ky investim kap vlerën prej 2 miliardë dollarësh.

LV-ja: Tenderi 12 milionësh i Përparim Ramës është i dyshimtë dhe favorizues

PRISHTINË, 11 GUSHT - Lëvizja Vetëvendosje (LV) në Prishtinë në një konferencë për medie ka kritikuar kryetarin e kryeqytetit, Përparim Rama, në lidhje me tenderin prej 12 milionë eurove për “Konsulencë për themelimin e shërbimit të arkitektit të kryeqytetit për nevojat e komunës së Prishtinës”. Asamblistët e kësaj lëvizjeje në Kuvendin Komunal të Prishtinës kanë thënë se kjo kontratë është e dyshimtë, pasi është fushë e njëjtë profesionale me atë të kryetarit Rama. Asamblistja Tria Kasumi-Berisha ka thënë se kryeqyteti

ka një listë të gjatë problemesh kronike por, sipas saj, është dhënë tenderi milionësh që është sa 13 për qind e buxhetit vjetor të komunës. “Banorët e këtij qyteti i cili karakterizohet me më së shumti qenë endacakë në rajon, qytet i cili është mbuluar me mbeturina, ka mungesë të ujit të pijshëm në disa lagje e fshatra, mungesë të ndriçimit publik, mungesë të rrugëve e cilësi të dobët të asfaltit, uzurpim të hapësirave publike e një listë të gjatë me probleme kronike, më emergjente e kanë themelimin e një shërbimi të arkitektit të kryeqytetit i cili Prishtinës i



kushton sa 13 për qind e buxhetit të përgjithshëm vjetor”, ka thënë Kasumi-Berisha.

Ndërsa Gëzim Sveçla, shef i asamblistëve i LV-së në Kuvendin Komunal të Prishtinës, ka thënë se kryetari

Rama nuk as ka vullnet e as vizion për t'i zgjidhur problemet e kryeqytetit. “Janë bërë tetë muaj prej që Përparim Rama e ka marrë pushtetin. Sot Prishtina është në gjendje më të keqe se para tetë muajve. Janë probleme reale, elementare, të thjeshta, të cilat zgjidhen lehtë. Mjafton vetëm vullnet dhe vizion. Disa probleme janë të trashëguara, disa kanë ardhur bashkë me Përparimin. Po ka shumë marketing, shumë kamuflime e punë konkrete hiç. Është shqetësues fakti se kryetari Rama ka filluar të ndihet rehat në këtë paretat të qytetarëve”, ka thënë Sveçla.

ATK-ja: Për 7 muaj janë realizuar mbi 435 milionë euro nga tatimet

PRISHTINË, 11 GUSHT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka bërë me dije se nga tatimet për shtatë muaj të këtij viti janë realizuar 435.9 milionë euro ose 31.1 milionë euro apo 7.7 për qind më

shumë sesa janë planifikuar. Sipas ATK-së, krahasuar me një vit më parë, është vërejtur se ka tejkalim për 80.3 milionë euro apo 22.6 për qind. “Të hyrat e përgjithshme nga tatimet për shtatë muaj të këtij

viti janë realizuar në vlerë 435.9 milionë euro ose 31.1 milionë euro apo 7.7 për qind më shumë se plani. Përderisa krahasuar me një vit më parë shohim se kemi tejkalim për 80.3 milionë euro apo 22.6 për

qind, Administrata Tatimore e Kosovës është e përkushtuar maksimalisht që të kemi zbatueshmëri të plotë të legjislacionit tatimor në mënyrë që vendi të ketë qëndrueshmëri fiskale”, ka njoftuar ATK-ja.



Kurthet e Asociacionit për funksionalitetin e shtetit të Kosovës



Shkruan: Valon MURATI

Arsyetimet se Asociacioni i cili nuk ka kompetenca ekzekutive dhe është në përputhje me Kushtetutën nuk është i dëmshëm, më së paku thënë është naiv. Çfarëdo grumbullimi i komunave serbe nën një ombrellë, me kuvend e kryetar dhe ushtrimi nga ana e tyre edhe i përgjegjësive të shumta që i kanë si komuna, do të nënkuptonte zgjerim vetjak të përgjegjësive ligjore dhe sidomos zgjerim i veprimtimit politik të këtij mekanizmi si përfaqësues i serbëve në Kosovë, përkatësisht në rrethanat në të cilat jemi, i Serbisë në Kosovë. Një mekanizëm i tillë do të fillonte ta bënte jetën e tij, jashtë kompetencave të tij ligjore e kushtetuese. Asnjë garanci ndërkombëtare nuk mund ta ndalojë as përpjekjen për veprim autonom territorial të këtij mekanizmi e as nuk mund ta ndalojë konfliktin e vazhdueshëm politik e juridik në mes të institucioneve të Kosovës dhe këtij mekanizmi në vazhdimësi.

Pozicioni i vështirë i Kosovës sa i përket marrëveshjes për Asociacionin

Kosova nuk është fare në pozicion të lehtë sa i përket marrëveshjes për Asociacionin të vitit 2013 cilin e ka nënshkruar dhe miratuar në Kuvendin e Kosovës. Ka një pajtim brenda garniturës politike kosovare si

dhe një pjesë të shoqërisë civile, analistëve dhe ekspertëve se marrëveshja për Asociacionin duhet të fillojë të zbatohet. Kjo thuhet me lehtësi pa analizuar pasojat që mund të ketë për Kosovën edhe një asociacion me kompetenca joekzekutive. Normalisht, në pamje të parë ky qëndrim duket parimor sepse kur insistohet në këtë rrugë kihet parasysh se Kosova veç i ka marrë këto obligime, përmes marrëveshjeve të viteve 2013 dhe 2015. Dhe në fund të fundit, pa marrë parasysh se çfarë kanë pohuar eksponentët e pushtetit aktual kur ishin në opozitë se Gjykata Kushtetuese në vitin 2015 e ka varrosur Asociacionin, në të vërtetë ajo ka pohuar se ai duhet të implementohet me vërejtjet që i ka bërë. Natyrisht të gjithë insistojnë se implementimi i Asociacionit duhet të jetë i bazuar në Kushtetutën e Kosovës, duke nënkuptuar se rrjedhimisht ai nuk do të jetë i dëmshëm nëse do të jetë i tillë. Në anën tjetër ndonjëherë lihet të nënkuptohet se shprehja e vullnetit për ta implementuar Asociacionin duhet të përdoret edhe si kartë e diplomacisë tonë me të cilën ne do ta vendosnin Serbinë në pozicion të vështirë negociues. Por në të vërtetë të gjithë janë të vetëdijshëm se edhe në variantin më optimist implementimi i Asociacionit është një punë Sizifi dhe se edhe qeveritë e mëhershme që nga ajo Mustafa, janë përpjekur të hartojnë

statutin e Asociacionit por se ky proces është bojkotuar nga përfaqësuesit politik serb në Kosovë. Duke qenë një projekt vështirë i realizueshëm dhe me pasoja të mëdha për funksionalitetin e shtetit të Kosovës, e duke u rrezikuar me projekte të tilla edhe stabiliteti i Kosovës, edhe me aminin amerikan u mundësua kalimi në atë që do të mund të quhet plani B për zgjidhjen e problemeve në mes të Kosovës dhe Serbisë, në atë të ripërcaktimit të kufijve. Fatkeqësisht për fatet e vendit ky projekt u demonizua në opinionin publik duke mos i dhënë mundësinë qytetare një debati normal e të civilizuar për të dhe rrjedhimisht u refuzua nga pjesa më e madhe e skenës politike. Andaj sot të gjithë arsyetohen, dhe duket në pamje të parë se kanë të drejtë se Kosova nuk ka shumë rrugë, duke qenë se presioni për zbatimin e Asociacionit do të peshojë rëndë mbi Kosovën. Në të vërtetë Kosova, në këtë drejtim vërtet se do të jetë nën presion, sepse përveç parullave të thata se "platforma jonë është kushtetuta", të thëna e stërthëna nga qeveritë dhe opozitat tash e 11 vite, nuk është se ato kanë shpalosur ndonjë opsion tjetër në tavolinë.

A është zgjidhje diskursi liberal?

Ka edhe një qasje që nuk është dominuese në diskursin tonë

politik, e që do të mund ta quanim si një diskurs liberal, që bazohet në zgjidhje jo etnike por qytetare. Kjo do të nënkuptonte se ne kemi probleme me serbët e Kosovës, se Serbia na njeh (apo nuk ekziston fare) dhe në atë relacion duhet të zgjidhet problemi. Përveç faktit se Kushtetuta e Kosovës në karakterin e saj njeh identitetet etnike dhe i fuqizon ato (sidomos atë serb), Kosova në thelb problemin dhe konfliktin nuk e ka mbaruar me Serbinë, e cila vazhdon të mos e njoh Kosovën dhe t'i hedh gur e dru konsolidimit të shtetësisë së saj. Serbët në Kosovë me gjithë përpjekjet tona, në këto rrethana nuk ka gjasë të shpëputen nga ndikimi i Beogradit, sidomos jo serbët në veriun e vendit të cilët e kanë edhe homogjenitetin etnik në një territor që po ashtu ka vazhdimësi territoriale me Serbinë. Për më tepër ne nuk mund të jemi egoistë e të merremi vetëm me Kosovën, por kemi obligim të ndihmojmë edhe shqiptarët në Kosovën Lindore. Andaj në këtë kontekst problemi Kosovë-Serbi, është një problem shqiptaro-serb. Ne nuk mund të trajtojmë problemin me serbët në Kosovë pa ndikimin e Serbisë. E po ashtu është e padrejtë që ne të merremi siç po merremi tani e sa vite vetëm me serbët në Kosovë dhe jo edhe me shqiptarët e diskriminuar në Kosovën Lindore. Koncepti qytetar dhe liberal, merr kuptimin e plotë pas

zgjidhjes së problemeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Deri sa ky problem mbetet hapur, tensionet etnike do të mbesin të larta dhe nuk shoh asnjë gjasë që të tilla zgjidhje të zbatohen në Kosovë, e aq më pak në Serbi.

Kurthet e Asociacionit

Projekti i Asociacionit vjen me kurthe të shumta, qoftë varianti që mund të hartohet dhe implementohet në përputhje me kushtetutën (e cila në vetvete për shkak të privilegjeve ndaj komunitetit serb i jep dorë Serbisë në Kosovë dhe i jep mundësi asaj ta destabilizojë dhe defunksionalizojë Kosovën), qoftë ai me kompetenca ekzekutive. Po ashtu ky projekt shtrun një sërë pyetjesh që duhet t'ia bëjmë vetes, por edhe partnerëve ndërkombëtarë. A na njeh Serbia me Asociacionin e vitit 2013/2015? A normalizohen marrëdhëniet me këtë Asociacion, dhe çfarë do të thotë 'normalizim i marrëdhënieve'? Pse duhet Serbia të na njoh për një fitore që ajo ka arritur në vitin 2013? Deri më tani, nga diplomatët e huaj, nuk është se ka ndonjë përgjigje të qartë në këto pyetje. Përmendet se Kosova e ka obligim realizimin e kësaj marrëveshjeje por ajo që lihet të nënkuptohet është se bisedimet duhet vazhdojnë deri te marrëveshja finale. Por bisedime për çka? Bisedime të pafundme teknike dhe gjysmë politike, që ne do të na mbanin në status quo,

në tensionime të vazhdueshme në procesin e implementimit të Asociacionit dhe në dëmtimin e mëtejshëm të funksionalitetit për shkak të Asociacionit i cili nuk do të ishte fundi i kërkesave të Serbisë? Çka fitojmë ne: liberalizimin e vizave, Këshillin e Evropës, UNESCO-n, Interpolin? A janë këto të mjaftueshme, për funksionalitetin tonë, apo edhe një karotë më tepër për ta shty vendin nga një krizë në tjetrën. A do të vijë pas Asociacionit kërkesa serbe për autonominë e veriut dhe insistimi i partnerëve tanë (të cilët shpesh e kanë përmend) për një status të veriut si të Tirolit Jugor, apo Komunitetit gjerman në Belgjikë (që nuk është vetëm kulturor e gjuhësor por edhe politik)? A do ta njohë Serbia pas zgjidhjeve të tilla Kosovën? Thënë të drejtën unë fare nuk besoj se Serbia ndonjëherë do ta njoh pavarësinë e Kosovës, por ajo me këtë format të bisedimeve dhe në këtë kontekst kohor e gjeopolitik (me një Rusi të zënë në luftën në Ukrainë me krejt pasojat e kësaj lufte dhe pozicionin serb në raport me të) do të blej kohë, për t'u treguar konstruktive dhe për të ecur para në integrimet evropiane. Kjo rrugë me këto projekte, përfshirë edhe Asociacionin me kompetenca jo ekzekutive e panjohje nga Serbia, duke mos qenë fare një zgjidhje populiste nuk besoj se pranohet nga kryeministri Kurti. Ai është ngritur në politikë mbi refuzimin e të gjitha opsioneve, duke përdorur në rrugën e tij drejt pushtetit jo vetëm refuzimin e këtyre opsioneve, por edhe metoda populiste jonsitucionaliste për fituar simpatinë e qytetarëve, por pa ofruar asnjëherë ndonjë zgjidhje racionale e funksionale për vendin. Kështu ndonjëherë kohëve të fundit duket i hapur në zbatimin e disa marrëveshjeve teknike me Serbinë, ai në thelb po blen kohë dhe simpati në arenën ndërkombëtare për të thënë Jo-në e madhe për çfarëdo marrëveshjeje që nuk është populiste. E në asnjë variant nuk ka marrëveshjeje populiste me Serbinë. Mund të ketë marrëveshjeje që Kosovën e bëjnë edhe më jo funksionale ose të tilla që e bëjnë funksionale. Kështu që zhvillime të tilla mund të shtrojnë rrugën prapë ndoshta për destabilizim politik, destabilizim i cili mund të na fus prapë në rrugën e zgjedhjeve të shpeshta, qeverive të dobëta në numra dhe me legjitimitet problematik politik për të realizuar ndonjë marrëveshje të madhe. Andaj një opsion i mundshëm dhe fatkeqësisht i dëshiruar nga shumica e skenës politike është vazhdimi i kësaj status-quo në të cilën ata janë specialistë të mbijetesës politike

dhe zotërimit të skenës politike.

Edhe një herë mbi Asociacionin me kompetenca joekzekutive

Arsyetimet se Asociacioni i cili nuk ka kompetenca ekzekutive dhe është në përputhje me kushtetutën nuk është i dëmshëm, më së paku thënë është naiv. Çfarëdo grumbullimi i komunave serbe nën një ombrellë, me kuvend e kryetar dhe ushtrimi nga ana e tyre edhe i përgjegjësive të shumta që i kanë si komuna, do të nënkuptonte zgjerim vetjak të përgjegjësive ligjore dhe sidomos zgjerim i veprimit politik të këtij mekanizmi si përfaqësues i serbëve në Kosovë, përkatësisht në rrethanat në të cilat jemi, i Serbisë në Kosovë. Një mekanizëm i tillë do të fillonte të bënte jetën e tij, jashtë kompetencave të tij ligjore e kushtetuese. Asnjë garanci ndërkombëtare nuk mund ta ndalojë as përpjekjen për veprim autonom territorial të këtij mekanizmi e as nuk mund ta ndalojë konfliktin e vazhdueshëm politik e juridik në mes të institucioneve të Kosovës dhe këtij mekanizmi në vazhdimësi. Kjo mund të kthehet në një betejë të pafund politike e ligjore. Ndërhyrja ndërkombëtare mund të zbus konfliktin që të mos e rezikojë sigurinë në Kosovë dhe sigurinë rajonale, por jo edhe ta zgjidh atë përderisa do të ekzistojë kjo kornizë kushtetuese. Madje me këtë zgjidhje edhe Serbia zyrtarisht mund të ndërhyjë si "palë konstruktive", siç ia bën herë pas here në Bosnjë dhe Hercegovinë. Asociacioni në çfarëdo variante është vetëm një prolongim i zgjidhjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe do të shtrojë rrugën për një formë të re të status-quo në Kosovë, e cila do të prodhojë të njëjtat kriza politike që i kemi ne, të njëjtën logjikë politike në qeverisje, të njëjtën populizëm, të njëjtën mungesë perspektive ekonomike, arsimore dhe zhvillimore. Vazhdim i dëmtimit të imazhit të vendit dhe vazhdim i mungesës së investimeve huaja mund të jenë probleme përcjellëse të një shtate të tillë

Cili do të duhej të ishte qëllimi i bisedimeve?

Në këtë rrethin vicioz të debateve që kemi bërë si shoqëri në mënyrë të pandërprerë tash e sa vite rreth bisedimeve, thuhet e stërthuhet se qëllimi i këtyre bisedimeve duhet të jetë njohja e dyanshme, eufemizëm ky për njohjen e Kosovës nga Serbia e që do të pasohet nga anëtarësimi

i Kosovës në organizatat ndërkombëtare si OKB, njohja nga ana e pesë shteteve anëtare të BE-së që do t'i hapte dyert për raport institucional me BE-në dhe mundësi për anëtarësim në NATO, etj. Nëse këto që u thanë më lartë, të cilat si synime janë të rëndësishme, janë qëllimet e vetme, a rezikojmë që duke pranuar të gjitha kompromiset e mundshme në emër të pranimit nga Serbia dhe në organizata ndërkombëtare ta minojmë aq shumë sovranitetin e dhe funksionalitetin e brendshëm sa të humb kuptimi i pavarësisë? Bosnja dhe Hercegovina është shtet i njohur nga Serbia dhe po ashtu anëtare në OKB, por cili është funksionaliteti i saj? Mos të flasim për shtete të tjera, anëtare të OKB-së, por që trajtohen si të brishta (në të kaluarën si të dështuara) si Somalia, Sudani Jugor, Siria, Afganistani etj. E duam një shtet, në cilin prapë ndërhyrja e Serbisë do të jetë e vazhdueshme, veç tash përmes mekanizmave shtesë kushtetues e ligjor të Kosovës? Edhe vetë Pakoja e Ahtisaarit që ishte një kompromis i madh në emër të pavarësisë, por edhe të njohjes nga Serbia dhe e cila solli pavarësinë por pa njohjen e Serbisë dhe e cila është përbrendësuar në sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës po ashtu i ka vendosur bazat e jofunksionalitetit të institucioneve tona. Tash shtoja kësaj Asociacionin, qoftë pa, qoftë me kompetenca ekzekutive! Po shtoja edhe ndonjë model autonomie për veriun! Cili do të ishte kuptimi i anëtarësimit në OKB apo njohjes nga Serbia? Zgjidhje të tilla do të na lodhnin shumë e do të na shndërronin në një vend me tensione të vazhdueshme politike dhe me mungesë optimizmi për të ardhmen. Sipas bindjes sime qëllimi kryesor i bisedimeve do të duhej të ishte rritja e funksionalitetit të shtetit të Kosovës në tërë territorin e saj dhe siguria për republikën tonë dhe qytetarët e saj. Njohja qoftë nga Serbia, qoftë nga pesë shtetet anëtare të BE-së, pranimi në OKB etj., do të duhej të ishin produkt i një marrëveshjeje të tillë, e jo qëllime të saj.

Rruga përpara

Nuk ka dyshim se Kosova nuk mund të vazhdojë të refuzojë opsione dhe të mos ofrojë asnjë projekt të saj, sepse atëherë vërtet do të vihemi nën presionin e realizimit të marrëveshjeve të nënshkruara por edhe të atyre që mund të vijnë si pjesë e presioneve ndërkombëtare. Qeveria jonë dhe partitë politike pozitive dhe opozitive, duhet të lëshojnë pozicionet e tyre të

betonizuara dhe duke e kuptuar rëndësinë e situatës të veprojnë me guxim, vendosmëri, kreativitet dhe ofensivë politike. Ne nuk kemi nevojë për politikan manipulues që fitojnë zgjedhjet me agenda populiste, por burrështetas që na i zgjidhin neve dhe gjeneratave të ardhshme problemet me Serbinë. Situata në veriun e vendit nuk është problem i kriminit të organizuar e as i një grupi të caktuar të serbëve të manipuluar nga Beogradi. Të dyja këto janë simptoma të problemit themelor, atë se në veriun e Kosovës legjitimiteti i shtetit të Kosovës kontestohet nga popullsia serbe duke e shndërruar këtë në një problem të thellë politik. Si në çdo vatër krize politike, krimi i organizuar gjen mundësinë për operim për shkak të rrethanave të përgjithshme, e natyrshëm shpesh duke bashkëjetuar e bashkëpunuar me politikën. Por problemet e thella politike, nuk zgjidhen as me polici, as me ushtri, e sidomos jo në këto rrethana të brendshme dhe ndërkombëtare në të cilat është Kosova. Veriu në këto rrethana ka vetëm zgjidhje politike. Janë naiv ata që mendojnë se Kosova me forcë mund të vendos legjitimitetin e saj në atë pjesë. Nuk ka shtet që e bën atë pa pajtimin e popullsisë lokale. Ajo që mund të prodhojë një situatë e tillë është jostabilitet i vazhdueshëm, tensione me rrezik të trazirave siç i pamë tani së fundmi, të shfrytëzuara në varësi të rrethanave herë nga Serbia, herë nga Rusia e herë nga të dyja bashkë. E para ka për qëllim të dëshmojë sesa projekt i dështuar është pavarësia e Kosovës, e dyta ka për qëllim të krijojë jostabilitet politik në rajonet gjeopolitike që janë nën ndikimin e aleancës veri atlantike. Sidoqoftë, jam prej atyre, që mendoj se luftë klasike në këto rrethana nuk mund të ketë, e as ndonjë sulm të hapur të Serbisë. Kjo do të ishte vetëvrasje e Serbisë dhe ajo nuk e bën këtë gabim. Këtu është KFOR-i, përkatësisht NATO-ja dhe SHBA-të të cilat mbrojnë jo vetëm Kosovën por edhe interesat e veta gjeopolitike dhe gjeostrategjike. Po flas për veriun e Kosovës, ndërsa për pjesën tjetër të Kosovës jemi edhe ne, institucionet e Kosovës, populli ynë dhe gatishmëria për të mbrojtur lirinë e fituar me shumë mund. Po cila duhet të jetë rruga përpara? Nuk ka dyshim se rrugë të lehtë përpara nuk kemi, por asnjëherë nuk kemi qenë në pozitë më të mirë si Kosovë dhe si shqiptarë që të insistojmë në zgjidhjen e problemeve me Serbinë. Së pari duhet ndryshimi i qasjes së

bisedimeve: jo bisedime teknike, e as bisedime të pjesshme politike, por bisedime politike për thelbin e problemeve e që do të çonte në marrëveshjen finale. Mbi cilin parim do të duhej të zhvilloheshin këto bisedime? Mbi reciprocitetin politik si qendra e bisedimeve: atë që kërkohet për veriun e Kosovës, duhet të vlejë edhe për Kosovën Lindore. Dhe ky parim të përdoret për të tejkaluar edhe presionin për Asociacionin. Asociacion për serbët në Kosovë, Asociacion për shqiptarët në Kosovën Lindore. Autonomi për veriun, autonomi për Kosovën Lindore. Madje kjo do të mund të vrente edhe për variantin e zgjidhjes qytetare: shtet krejtësisht qytetar në Kosovë, shtet qytetar në Serbi. Në këtë drejtim reciprociteti politik sa i përket të gjitha opsioneve është jo vetëm parimi i duhur por edhe i vetmi i drejtë dhe që i vë palët në pozita barazie. Po cila duhet të jetë zgjidhja finale? Ripërcaktimi i kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë si zgjidhja e vetme që Kosovën e bën funksionale. Një zgjidhje e tillë, jo që ndalon krijimin e Asociacionit, por krijon mundësinë për ndryshimet kushtetuese për të hequr privilegjet bllokuese për serbët dhe mbajtur vetëm të drejtat për pakicat, dhe e cila do të funksionalizonte tërësisht Kosovën. Po ashtu me këtë zgjidhje Kosova Lindore do t'i bashkohej Kosovës, duke kryer edhe një obligim kombëtar, shtetëror e ne të gjithë edhe njerëzor që kemi ndaj asaj pjese të kombit. Krejt në fund kjo zgjidhje e hap edhe mundësinë për të diskutuar dhe dizajnuar edhe procesin e bashkimit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë nëse për këtë ka vullnet popullor dhe politik. Nuk jam naiv të mendoj se kjo zgjidhje është e lehtë. Është shumë e vështirë, por nuk shoh rrugë tjetër. Duke e kuptuar se përmendja e kufijve njëherë mund të duket traumatike, rruga e duhur është që ne të fillojmë menjëherë të vendosim në tryezën e bisedimeve Kosovën Lindore dhe zgjidhjen e problemeve atje përmes zbatimit të reciprocitetit me veriun e Kosovës. Përndryshe nëse do të vazhdojmë të flasim vetëm për zgjidhje brenda Kosovës, të gjitha zgjidhjet vetëm për të, qoftë mbetja e kësaj status quoje, qoftë Asociacioni në të gjitha variantet e tij, e qoftë edhe ndonjë autonomi për veriun, do të na lodhin aq shumë në planin afatgjatë sa kur të kërkojmë vetë që të kthehemi tek ripërcaktimi, rezikojmë të mos kemi më shqiptarë në Kosovën Lindore dhe të kemi betonizim të Serbisë tek lumi Ibër.

Pse shkenca nuk po mbështet më ateistët, dhe ka filluar t'i drejtohet Zotit?



Nga Stephen C. MEYER
"Newsweek"

Lajmet e kohëve të fundit, nuk kanë qenë inkurajues për besimtarët. Një sondazh i Gallup, tregon se përqindja e amerikanëve që besojnë në Zot ka rënë në 81 për qind. Një rënie prej 10 për qind gjatë dekadës së fundit, dhe niveli më i ulët historik.

Kjo tendencë përshpejtuese, është veçanërisht më e theksuar tek të rinjtë. Sipas një sondazhi të Qendrës Kërkimore Pju, 18-29 vjeçarët janë të përfaqësuar në mënyrë disproporcionale midis të ashtuquajturve ateistë, gnostikë, dhe pa lidhje me ndonjë besim fetare.

Pastorët dhe udhëheqësit e tjerë fetarë, ia atribuojnë këtë prirje shumë faktorëve: rritja e të rinjve jashtë kishës, mosnjohja e liturgjisë dhe kulturës së kishës, madje edhe Covid-19. Ne gjetëm një përgjigje tjetër në sondazhin tonë kombëtar, në lidhje me arsyet themelore për këtë mosbesim në rritje: keqkuptimi ndaj shkencës.

Sondazhi ynë zbuloi se mesazhi i perceptuar i shkencës, ka luajtur një rol kryesor në humbjen e besimit. Ne zbuluam

se sidomos teoritë shkencore rreth evolucionit të jetës, kanë nxitur më shumë njerëz ta refuzojnë besimin në Zot, sesa shqetësimet për vuajtjet, sëmundjet ose vdekjen.

Po ashtu, ai tregoi se 65 për qind e ateistëve të vetë-cilësuar si të tillë, dhe 43 për qind e agnostikëve besojnë se "gjetjet e shkencës në përgjithësi, e bëjnë më pak të mundshme ekzistencën e Zotit. Është e lehtë ta kuptosh arsyen pse ky perceptim është kaq i përhapur.

Vitet e fundit, shumë shkencëtarë janë shfaqur si zëdhënës të famshëm të ateizmit. Riçard Doukins, Lorenc Kraus, Bill Naje, Majkëll Shermer, i ndjeri Stefën Houking dhe të tjerë kanë botuar libra popullore, ku argumentojnë se shkenca e bën të panevojshëm apo të pabesueshëm besimin në Zot.

"Universi që vëzhgojmë ka vetitë që ne duhet të presim nëse në fund, nuk ka asnjë qëllim, asnjë projekt... Asgjë tjetër veçse indiferencë e verbër dhe e pamëshirshme"- shkroi Doukins.

Megjithatë, midis mesazhit dhe realitetit, ekziston një hendek i madh.

Gjatë shekullit të kaluar, zbulime të rëndësishme shkencore e kanë sfiduar fort ateizmin e bazuar tek shkenca. Dhe në veçanti 3 prej tyre, tregojnë një histori shumë më miqësore ndaj Zotit.

Së pari, shkencëtarët kanë zbuluar se Universi fizik e kishte një fillim. Ky zbulim, i mbështetur nga astronomia vëzhguese dhe fizika teorike, bie ndesh me pritshmëritë e ateistëve shkencorë, të cilët prej kohësh e portretizuan Universin si të përjetshëm dhe vetë-ekzistent, dhe që rrjedhimisht nuk ka nevojë për një krijues të jashtëm.

Dëshmitë për atë që shkencëtarët e quajnë Big Beng, kanë konfirmuar pritshmëritë e teistëve tradicionalë. Fituesi Çmimit Nobel Arno Penzias, që ndihmoi në arrijten e një zbulimi kyç në mbështetje të teorisë së Big Bengut, ka vënë në dukje lidhjen e dukshme midis pohimit të tij të një fillimi kozmik dhe konceptit të krijimit hyjnor. "Të dhënat më të mira që kemi janë pikërisht ato që do të kisha parashikuar, po të mos kisha asgjë tjetër përveç 5 librave të Moisiut...dhe Biblës në tërësi"- shkruan Penzias.

Së dyti, zbulimet nga fizika rreth

strukturës së Universit e përforcojnë këtë përfundim teist. Që nga vitet 1960, fizikanët kanë përcaktuar se ligjet dhe parametrat themelorë fizikë të Universit tonë janë përshtatur mirë, përkundër të gjitha gjasave, për ta bërë Universin tonë të aftë të mbajë jetën.

Edhe ndryshimet më të vogla midis shumë faktorëve të pavarur – si forca e tërheqjes gravitacionale ose elektromagnetike, ose rregullimi fillestar i materies dhe energjisë në Univers – do ta kishin bërë të pamundur jetën. Shkencëtarët kanë zbuluar se ne jetojmë në atë që fizikanti australian Ljuk Barnes e quan një "Univers me fat".

Nuk është për t'u habitur që shumë fizikanë kanë arritur në përfundimin, se ky rregullim flet për një "akordim kozmik shumë të detajuar". Siç argumentoi ish-astrofizikani i Kembrixhit, Sër Fred Hojl "Një interpretim logjik i të dhënave sugjeron, se një super-intelekt është bashkuar me fizikën për të bërë të mundur jetën".


Së treti, biologjia molekulare ka zbuluar praninë tek qelizat e gjalla të një bote të imët të nanoteknologjisë informative. Këto përfshijnë kodin dixhital në

ADN dhe ARN, makineri të vogla molekulare, të ndërtuara në një mënyrë shumë të ndërlikuar, të cilat e tejkalojnë shumë teknologjinë tonë dixhitale sa i përket aftësisë së tyre të ruajtjes dhe transmetimit.

Madje edhe vetë Riçard Doukins e ka pranuar se "kodi i makinës së gjeneve, është shumë i ngjashëm me kompjuterin", duke nënkuptuar veprimtarinë e një programuesi mjeshtëror në fillimet e origjinës së jetës. Zbulimet e biologjisë moderne, nuk janë ato që do të priste dikush nga proceset thjesht materialiste.

E gjitha kjo nënvizon një pabarazi në rritje midis perceptimeve publike për mesazhin e shkencës, dhe asaj që tregojnë faktet shkencore. Zbulimet e mëdha të shekullit të kaluar, nuk tregojnë një "indiferencë të verbër dhe të pamëshirshme", por për projektin e detajuar të jetës dhe Universit, dhe ndoshta për një krijues inteligjent që qëndron pas të gjithave.

Shënim: Stephen C. Meyer, drejton Qendrën për Shkencë dhe Kulturë në Discovery Institute në Siatëll, SHBA.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Dardan Berisha konfirmon largimin, KB Peja paraqet Isiah Umipig

Basketbollisti më i mirë vendor, Dardan Berisha, përfundimisht është ndarë me skuadrën e Pejës dhe karrierën pritet ta vazhdojë në KB Sigal Prishtina. Skuadra pejane nuk ka qëndruar duarkryq pas largimit të Dardan Berishës, pasi të enjten e ka paraqitur amerikanin Isiah Umipig

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PEJË, 11 GUSHT - Një prej basketbollistëve më të mirë që nga paslufta, Dardan Berisha, edhe zyrtarisht është larguar nga KB Peja. Lajmin e ka konfirmuar basketbollisti pejan në "Facebook". Ai i ka falënderuar të gjithë në klub, kurse ka thënë se ky vit do të mbetet përgjithmonë në kujtesën e tij. "Të dashur qytetarë të Pejës, tifozë 'Shqiponjat' dhe dashamirë të

basketbollit, dua t'ju informoj se nga ky vit nuk do të jem më pjesë e KB Peja. Me këtë rast falënderoj nga zemra qytetarët, tifozët, bashkëlojtarët si dhe të gjithë ata të cilët më përkrahen gjatë rrugëtimit tim. Ishin vite të jashtëzakonshme dhe përherë do të mbetet në kujtimet e mia", ka shkruar Berisha në "Facebook".

Gazeta mëson se Berisha është shumë afër marrëveshjes me skuadrën e Sigal Prishtinës dhe shumë shpejt pritet të

bëhet edhe zyrtarizimi i tij në klubin kryeqytetas. KB Peja nuk ka qëndruar duarkryq pas largimit të Dardan Berishës, pasi të enjten e ka paraqitur amerikanin Isiah Umipig. "KB Peja njofton se ka nënshkruar kontratë me lojtarin amerikan, Isiah Umipig", thuhet në njoftimin zyrtar të klubit. Umipig luan ka një përvojë të gjatë në NCAA, Sllovaki, Kanada, Turqi, Lituanë, Ukraine dhe në sezonin e fundit ishte pjesë e Ligës elite të Zvicrës, tek ekipi BBC Nyon.



Istrefi synon të paraqitet për Kosovën A

PRISHTINË, 11 GUSHT - Basketbollisti i talentuar Bardh Istrefi këtë vit është paraqitur me dy grupmoshat në përfaqësueset e Kosovës. Istrefi ishte pjesë e U-20 dhe U-18, ku në këtë të fundit ishte shënuesi më i mirë i kampionatit. Në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së, Bardhi ka folur rreth vitit 2022. "Viti 2022 për mua ka qenë një vit sfidues. Në janar të këtij viti



kam shkuar në Gjermani për të luajtur në ekipin Giessen 46 Ers, që i bie në gjysmë të edicionit. Më ka marrë kohë

pak të njihem me ekipin, mënyrën e lojës, aksionet etj. Pastaj u ktheva në Kosovë që të luaj për U20 dhe U18 në Kampionatet Evropiane", ka thënë Istrefi.

Më tutje Istrefi ka folur edhe rreth Kampionatit U-18, ku u dallua si shënuesi më i mirë i gjithë kampionatit me 156 pikë gjithsej. "Mendoj se si shënuesi më i mirë do të më japë motiv më shumë që të

vazhdoj tutje. Si ekip kemi mundur të luajmë më mirë. Kemi mundur që së paku edhe dy ndeshje t'i fitojmë", ka deklaruar Istrefi për faqen zyrtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës.

I pyetur që nëse ëndërron që ta veshë fanellën e Kosovës A, ai është shprehur: "Dëshirat janë maksimale, por të shohim se çka do të na sjellë edhe e ardhmja. Tash për tash jam i

fokusuar që të zhvillohem sa më shumë si lojtar dhe të kontribuoj në ekipin ku luaj. Do të ishte kënaqësi dhe nder, po ashtu edhe përgjegjësi të luash për Përfaqësuesen, pavarësisht në cilin nivel, e aq më shumë për Përfaqësuesen A". Bardh Istrefi është pjesë e Giessen 46 Ers U19 që garojnë në ligën NBBL dhe, po ashtu, për ekipin e dytë të seniorëve në ligën ProB.

Vajzat e arta të Istogut

PRISHTINË, 11 GUSHT - Hendbollistet e Istogut, Yllka Shatri, Blerta Ahmetxhekaj dhe Adelina Berisha, janë prej sportistëve më të trofeshme në vendin tonë. Ato në karrierën e tyre së bashku me skuadrën e Istogut kanë arritur të fitojnë plot 10 trofe. Nuk ka trofe në hendbollin e Kosovës që nuk ka kaluar të paktën dy herë në duart e arta të këtyre sportistëve

shembull të komunës së Istogut. Trofetë e fituar: 2 tituj të kampionit të Kosovës, grupmosha U15, 2 tituj të kampionit të Kosovës, grupmosha U18, 4 kupa të Republikës së Kosovës për sendore, 2 tituj të kampionit të Kosovës për seniore. Pra 10 trofe me një ekip, shifër e lakmuar nga çdo sportist. Ky është viti i gjashtë që me skuadrën e Istogut



do ta përfaqësojnë Kosovën në Kupa Evropiane. Yllka, Blerta dhe Adelina janë paraqitur për të

gjitha gjeneratat e Kosovës. Së fundmi me ekipin e Universitetit ishin të tretat në Kupën Botërore të universiteteve, pasi që janë edhe studente të Universitetit të Prishtinës, të dalluara në mësim dhe me nota të larta. "Shatri, Ahmetxhekaj e Berisha kanë dalë nga academia e klubit. Janë pra sportiste të trofeshme dhe studente të dalluara me një të ardhme të ndritur. Janë

shembull që duhet ndjekur nga gjeneratat e reja që synojnë karrierë të suksesshme. Tani ato kanë arritur moshën e pjekurisë sportive dhe po bartin barrën kryesore të skuadrës. KHF Istogu ju dëshiron shëndet, fat dhe shumë trofe të tjerë me skuadrën! Faleminderit Yllka, Blerta, Adelina! Jemi me fat që ju kemi", thuhet në postimin e KHF Istogu.

Kosova U18 mposhtet nga Turqia

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ka pasur përmirësime të ndjeshme në lojën e Kombëtares U18 të Kosovës në hendboll në krahasim me dy ndeshjet e para në Kampionatin Evropian të Divizionit B që po mbahet në Letoni. Ndonëse

përmirësimi ishte i ndjeshëm, djemtë tanë e kanë humbur edhe ndeshjen e tretë në fazën grupore. Të enjten në Riga, Kosova U18 pësoi nga Turqia me rezultat 29:23. Pas pjesës së parë rezultati ishte 18:10. Në

periudha ka funksionuar loja jonë, por djemtë e kanë kuptuar që për paraqitje të nivelit më të lartë duhet të punojnë shumë më tepër. Gjithsesi përvoja në këtë Evropian do të shërbejë shumë për këtë gjeneratë që

po i luan ndeshjet e para zyrtare ndërkombëtare. Elion Goçi, Amar Muqolli e Olsi Mulaj kanë shënuar nga pesë gola ndaj Turqisë. Goçi i kishte shtatë tentime, Muqolli nëntë, ndërsa Mulaj njëmbëdhjetë. Faza grupore



në Evropian ka përfunduar, ndërsa kanë mbetur ndeshjet për plasman.


Fanella e Jordanit shitet rreth pesë milionë dollarë

CHICAGO, 11 GUSHT - Fanella e një prej basketbollistëve më të mirë në histori, Michael Jordan, të cilën e veshi gjatë serisë së fundit të "play-off"-it në karrierën e tij në NBA, u shit në një ankand për një

shumë të pabesueshme prej pesë milionë dollarësh. Siç raportojnë mediet botërore, bëhet fjalë për fanellën e famshme të kuqe të Çikagos me numrin 23 nga ndeshja e parë e serisë finale kundër

Jutas në vitin 1998. Jordani më pas udhëhoqi Chicago në një triumf në finale dhe kampionatin e tij të gjashtë. Kjo është fanella e dytë sportive më e shtrenjtë e shitur ndonjëherë dhe më e

shtrenjta kur bëhet fjalë për basketboll, pas fanellës së futbollistit të famshëm argjentinas Diego Armando Maradona të vitit 1986, e cila u shit për 9.3 milionë dollarë.



Ancelotti: Duam të vazhdojmë të fitojmë trofe

MADRID, 11 GUSHT - Reali i Madridit e ka fituar Superkupën e Evropës, pasi në finale e mposhti Eintracht Frankfurtin me rezultat 2-0. Trajneri Carlo Ancelotti është shprehur i kënaqur me suksesin e arritur dhe ka paralajmëruar se synim i "mbretërve" është të vazhdojnë të fitojnë trofe. "Ne nuk kemi nevojë që përmes kësaj loje të tregojmë se kemi ekip të fuqishëm. Ne jemi të motivuar dhe duam të vazhdojmë të fitojmë. Ndeshja tregoi se ishte më e vështirë se që e prisnim. E kontrolloam lojën pas golit të parë të Alabas dhe nuk ishim të rrezikuar. Jemi ende solidë prapa dhe nuk kemi pësuar gol në tri finalet e fundit. Kjo është një shenjë mjaft inkurajuese", ka thënë Ancelotti. "Ekipi është në rrugë të mirë dhe është kënaqësi t'i drejtosh këta lojtarë, ka një balancë të mirë këtu. Ndeshjet janë të mëdha dhe fitoret na ndihmojnë ta mbajmë zhuftoren të shëndetshme. Ndikon te lojtarët. Një vit më parë, askush nuk kishte besim



në këtë ekip. Skuadra u ngrit dhe u përmirësua shumë vitin e kaluar, por ka ende hapësira për t'u përmirësuar. Ne kemi bërë shumë hapa përpara", ka shtuar

Ancelotti. Italiani e fitoi Ligën e Kampionëve, më pas La Ligan dhe tash Superkupën e Evropës, në përvojën e tij të dytë në "Santiago Bernabeu".

Drejtori i Mercedesit: Kemi mësuar shumë në këtë sezon

STUTTGART, 11 GUSHT - Toto Wolff, drejtori sportiv i Mercedesit, ka folur për këtë sezon të Formula 1, ku skuadra gjermane është gjendur në vështirësi dhe e papërgatitur për të dueluar për titullin. "Në provat zyrtare jemi shumë larg rivalëve, por gjatë garës kemi treguar se jemi më kompetitivë. Praktiksht jemi ngjitur në podium në çdo garë", ka thënë Wolff. "Makina është në përmirësim të vazhdueshëm. E vërtetë që Ferrari e Red Bulli kanë bërë një punë më të mirë se e jona, por kur humbet arrin të mësosh më shumë. Dhe ju garantoj se leksioni që kemi marrë këtë vit ka qenë mjaft i rëndësishëm. Pasi rrezohesh mëson të ngrihesh e të vazhdosh të ecësh përpara", ka shtuar Wolff. "Jam i sigurt se ky sezon do të na shërbejë shumë për



të ardhmen dhe do të arrijmë sërisht të jemi protagonistë, siç kemi qenë gjatë dekadës së fundit. Ky sezon ka qenë një shuplakë e

fortë, por mendoj se kemi reaguar. Sezioni është ende i gjatë, ndaj mund të kemi të tjera çaste pozitive", u shpreh Toto Wolff.

SHKURT

Priestley huazohet te KF Vushtrria

Skuadra e Dritës nga Gjilani ka njoftuar se Esosa Priestley është huazuar në skuadrën e Vushtrrisë, e cila bën gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. "Lojtari ynë Esosa Priestley është transferuar në formë huazimi për një vit tek ekipi i Vushtrrisë. Priestley është pjesë e klubit nga janari 2020 dhe sezonin e kaluar ishte pjesë e KF Ulpiana në formë huazimi. Me t'u rikthyer në ekip, Priestley ishte pjesë e ekipit për ndeshjet e Evropës", thuhet në njoftimin e Dritës.

Gruaja e Xhakës: Granitin nuk e zë gjumi kur humbet Arsenalit

Gruaja e Granit Xhakës, Leonita, ka folur për bashkëshortin e saj në dokumentarin kushtuar skuadrës së Arsenalit "All or Nothing" Sipas saj, mesfushorin nuk e zë gjumi kur skuadra humbet. "Kur ata humbasin një ndeshje dhe ai kthehet në shtëpi, është vërtet i mërzhitur", tregon Leonita në dokumentarin "All or Nothing". "Unë përpiqem të flas pak me të dhe t'i them se ndeshja e ardhshme do të shkojë më mirë. Por... ai nuk fle gjumë gjithë natën kur ata humbasin", ka shtuar ajo. Siç dihet, tashmë kanë filluar të transmetohen episodet e dokumentarit i cili këtë vit iu dedikua skuadrës së Arsenalit.

Aubameyangu nuk largohet nga Barça

Xavi Hernandez nuk e ka pranuar ofertën e Chelseat për transferimin e sulmuesit Pierre Emerick Aubameyang. Londinezët kishin shprehur interesim për sulmuesin gabonez dhe mesfushorin Frenkie de Jong dhe thuhej se ishin afër zyrtarizimit të tyre. Mirëpo, sipas "AS", Aubameyang do të vazhdojë të qëndrojë te Barcelona, pasi ai është pjesë e planeve të teknikut spanjoll.

Roma i ofron kontratë të re Zaniolos

E ardhmja e Niccolo Zaniolos merr një kthesë të papritur. Roma i përgjigjet interesimit të Milanit, Juventusit dhe e Tottenhamit, duke i ofruar sulmuesit "azzurr" rinovimin e kontratës. Sipas "Corriere dello Sport", drejtuesit e klubit verdhekuq janë të gatshëm t'i ofrojnë Zaniolos një kontratë të re, aktualja përfundon më 2024. Në kontratën e re, parashikohet edhe një rritje e ndjeshëm e pagës, nga 2.5 milionë euro në 4 milionë euro plus bonuse. Me këtë lëvizje, Roma konfirmon edhe një herë se objektivi i tyre kryesor është minimalisht prania në Ligën e Kampionëve, por me grupin e krijuar nga Jose Mourinho as titulli nuk është më një gjë e pamundur.

PSG-ja 'detyron' Icardin të largohet

Dikur një sulmues luksi, tanimë rrezikon të luajë me të rinjtë. Sa shumë ka ndryshuar karriera e Mauro Icardit në tri vjetët e fundit.

Prishja e marrëdhënieve me klubin që e bëri një nga sulmuesit më të mirë në botë, Interi dhe transferimi te klubi që mbledh më të mirët

në botë, PSG-ja rezultoi "vetëvrasje" për argjentinasin. Sipas "L'Equipe", klubi francez ka nxjerrë zyrtarisht jashtë

ekipit të parë sulmuesin argjentinas, për t'i bërë vend 20-vjeçarit Ekitike. PSG-ja kërkon që të lirohet sa më shpejt nga paga e

argjentinasit por, për fat të keq, ofertat për të mungojnë dhe klubi i vetëm që ka shfaqur interesim për të është Monza.



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli: Asistent/e Ekzekutiv/e - 1 (një) pozitë

Nr. i referencës: NPB/KKE/02.3

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Niveli i pagës: 6

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të pacaktuar (puna provuese deri në 3 muaj)

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Planifikon orarin e takimeve zyrtare të KE-së dhe informon palët zyrtare për takimet;
- Pranon kërkesat e palëve dhe partnerëve zyrtar të cilët kërkojnë takim me KE-në;
- Mban korrespondencat me palët e brendshme dhe të jashtme;
- Lexon dhe analizon shkresat, dokumentet dhe raportet e pranuar në mënyrë që të përcaktojë rëndësinë e tyre si dhe të planifikojë shpërndarjen e tyre,
- Shpërndan korrespondencat e pranuar, përfshirë edhe fakset dhe postën elektronike,
- Është përgjegjës/e për mbajtjen dhe ruajtjen e të gjitha dokumenteve të rëndësishme të Ndërmarrjes, të nënshkruara nga KE;
- Mban procesverbalet e mbledhjes së Menaxhmentit dhe i procedon tek pjesëmarrësit;
- Për kryerje të detyrave dhe përgjegjësi i përgjigjet KE;
- Mban procesverbalet e mbledhjes së Menaxhmentit dhe i procedon tek pjesëmarrësit;
- Kryen detyra tjera të përcaktuara nga KE.

Kualifikimi:

- Shkollim i lartë;
- Së paku 2 vite përvojë të dëshmuar pune në administratë.

Aftësitë:

- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Aftësi të mira komunikuese në të shkruar dhe në të folur;
- Efikas/e në punë ekipore;
- Të ketë njohuri pune me kompjuter Word, Excel, Access, Outlook, Internet.
- Të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë.

Kualifikime të tjera:

- Kurset dhe trajnimet tjera profesionale gjate karrierës
- Njohja e gjuhës serbokroate

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën:

www.npbanesore.com/shpalljet/mundesipunesimi/. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në

Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Ulpianë - Prishtinë, të aplikojnë

përmes emailit zyrtar: burimet.njerzore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët

konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm

kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikacionit i duhet bashkëngjitur;

- Formulari për aplikim i NPB-së;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga gjykata e cila dëshmon që nuk është i/e dënuar (jo më e vjetër se gjashtë muaj);

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda dy (2) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHOYRTOHEN.

Shpallja është e hapur që nga data: 11.08.2022-25.08.2022

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.

ANADRINIA MED

SHKOLLA E MESME E LARTË E MJEKËSISË
PRIZREN

Rr."JONI", nr. 47, 20000 Prizren, Kosovë, email: anadriniamed@gmail.com /
kbiznesi@gmail.com
Tel: +383 44/49 500 878 : +383 29 230 555

Bazuar në nenin 15 të Statutit, të SHMLM "ANADRINIAMED" Prizren, Këshilli Drejtues shpallë:

KONKURS

Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë Anadrinia MED shpall konkurs për pranimin e nxënësve të rinj në klasën e dhjet (X-të), për vitin shkollor 2022/2023

Në drejtimin e licencuar për Arsimin e Mesëm të Lartë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si:

- **Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë**

Konkursi është i hapur nga date e shpalljes deri me datën 30.08.2022.

Të drejtën e konkurrimit e kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë të përfunduar shkollimin e mesëm të ulët dhe të cilët e kanë përfunduar me sukses testin e arritshmërisë.

Dorëzimi i dokumenteve nga kandidatët e interesuar duhet të bëhet në mënyrë fizike në ambientet e shkollës.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet t'i bashkëngjitin aplikacionit:

Certifikatën e kalimit të testit të arritshmërisë për klasat e nënta (origjinale ose kopje të noterizuar);

Diplomën e shkollës së mesme të ulët (origjinale ose kopje të noterizuar);

Dëftesat e shkollës së mesme të ulët (origjinale ose kopje të noterizuar);

Certifikata e lindjes;

Dy fotografi;

Paraqitja e dokumenteve: Rr."JONI", nr. 47, 20000 Prizren, Kosovë ose përmes
e-mail: anadriniamed@gmail.com / kbiznesi@gmail.com
Tel: +383 44/49 500 878 : +383 29 230 555

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Trend International L.L.C me seli në Prishtinë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 811507881

► Jehona Islamaj nga Peja shpall të pavlefshme diplomën e U.P. "Fehmi Agani" në Gjakovë Edukim Parashkollorë.

► Valdete Këpuska nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

► Ida Cakolli shpall të pavlefshme dëftesën e kl. -X- të Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

► Arbër Hana nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Mazllom Këpuska" Gjakovë nga kl. I,V dhe VI-IX.

► Valbone Hasani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Yll Morina" Gjakovë nga kl. I-VIII.

► Albert Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët.

► Angelina Gojani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

